

**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**  
**Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë**

**Departamenti: Agroekonomi**  
**Programi: Ekonomi e bujqësisë dhe ushqimit**



**PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

**Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e perimeve: spec  
dhe patate në Kosovë**

**Mentor:**

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

**Kandidatja:**

Rina Berisha

**Prishtinë, 2021**



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**  
**Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë**

**Departamenti: Agroekonomi**  
**Programi: Ekonomi e bujqësisë dhe ushqimit**



**PUNIM I DIPLOMËS MASTER**

**Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e perimeve: Spec  
dhe Patate në Kosovë**

**Mentor:**

Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj

**Kandidatja:**

Rina Berisha

**Prishtinë, 2021**



## **Deklaratë për punimin**

Unë Rina Berisha, i/e lindur më datë 17.06.1997 në Prishtinë, Komuna e Prishtinës, si studente e masterit në Departamentin e “AGROEKONOMISË”, para mbrojtjes së punimit të masterit, nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim i masterit me titull: **Analizimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e perimeve: spec dhe patate në Kosovë** është punuar prej meje. Punimi nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë e veçantë e tij. Punimi në tërësi u përmbahet rregullave për plagjiaturë. Punimi, nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara. Andaj vetëm unë mbaj përgjegjësi personale deri në anulim të titullit të fituar në bazë të mbrojtjes së këtij punimi. Përgjegjësi për plagjiaturë në asnjë formë nuk mbajnë institucioni dhe anëtarët e komisionit.

Deklaratën e nënshkruaj në prezencë të personit zyrtar.

Prishtinë,

Datë \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i kandidatit/es \_\_\_\_\_



## FALENDERIME

Ky studim nuk do të mund të ishte gjallëruar nëse nuk do t'i kisha pranë disa nga njerëzit entuziast dhe pozitiv.

Përgjatë procesit të hulumtimit dhe studimit kam pasur vështirësi në zgjidhjen e problemeve të shfaqura gjatë rrugës, mirëpo me mbështetjen e mentorit Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj dhe kolegeve, ato probleme u bënë gjithënjë e më të lehta. Prandaj, falënderoj mentorin e temës në fjalë, i cili ishte i gatshëm gjithmonë të ndihmonte në realizimin e studimit në çdo fazë të procesit. E gjithashtu, falënderoj edhe tri koleget: Blertha Vehapi, Diellza Dibrani dhe Fatlinda Imeri, me të cilat punën në teren e realizuam bashkë, me plot kufizime dhe barriera të paraqitura gjatë rrugës.

Duke mos harruar të falënderoj edhe familjen time, të cilët më mbështetën gjatë tërë kohës dhe më dhanë motivim dhe vullnet të vazhdoja drejt suksesit.

# PËRMBAJTJA

Lista e figurave.....	VI
Lista e tabelave.....	VII
ABSTRAKT .....	VIII
ABSTRACT .....	IX
KAPITULLI 1: HYRJE .....	1
1.1. Identifikimi i problemit .....	1
1.2. Qëllimi, objektivat dhe hipotezat e hulumtimit.....	3
1.3. Pyetjet hulumtuese dhe hipotezat.....	3
1.3.1. Pyetjet hulumtuese.....	3
1.3.2. Hipotezat .....	4
1.4. Rezultatet e pritshme.....	4
1.5. Struktura e punimit.....	5
KAPITULLI 2: RISHIKIMI MBI LITERATURËN E FUSHËS .....	6
2.1. Prodhimtaria e perimeve .....	6
2.2. Zinxhiri i vlerës së bujqësisë në Kosovë.....	11
2.2.1. Përpunuesit .....	14
2.2.2. Tregtarët.....	14
2.2.3. Furnizuesit e inputeve.....	15
2.2.4. Koordinimi Horizontal dhe Vertikal.....	16
2.2.5. Mjedisi i përshtatshëm.....	17
2.3. Zinxhiri Global i Vlerës .....	18
2.4. Metoda e vlerësimit të shpejtë.....	21
KAPITULLI 3: METODOLOGJIA DHE METODAT E HULUMTIMIT .....	23
3.1. Metodologjia e aplikuar .....	23
3.1.1. Informata lidhur me pyetësin.....	24
KAPITULLI 4: REZULTATET .....	25
4.1. Vlerësimi i Faktorëve .....	25
4.1.1. Tregu Ndërkombëtarë.....	26



4.1.2.	Kulturat (speca & patate).....	27
4.1.3.	Inputet.....	28
4.1.4.	Fuqia punëtore.....	30
4.1.5.	Struktura e tregut.....	31
4.1.6.	Makroekonomia.....	32
4.1.7.	Koordinimi i zinxhirit të vlerës.....	34
4.2.	Kontrollueshmëria, Relevanca dhe Vërtetimi i hipotezave .....	35
4.2.1.	Relevanca – Koordinimi vertikal dhe horizontal.....	36
4.2.2.	Relevanca – Politikat bujqësore.....	39
4.2.3.	Relevanca - Fidanet.....	42
KAPITULLI 5: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....		44
5.1.	Përfundime .....	44
5.2.	Rekomandimet .....	47
Referencat.....		49
Aneks.....		52

## Lista e figurave

Figure 1: Akterët kryesor të zinxhirit të vlerës .....	13
Figure 2: Vlerësimi i faktorit "Tregu Ndërkombëtarë" .....	26
Figure 3: Vlerësimi i faktorit "Kulturat (speca dhe patate)" .....	27
Figure 4: Vlerësimi i faktorit "Inputet" .....	28
Figure 5: Vlerësimi i faktorit "Fuqia punëtore" .....	30
Figure 6: Vlerësimi i faktorit "Struktura e tregut" .....	31
Figure 7: Vlerësimi i faktorit "Koordinimi i zinxhirit të vlerës" .....	34
Figure 8: Relevanca për nënfaktorin "Koordinimi Vertikal" .....	36
Figure 9: Relevanca për nënfaktorin "Koordinimi Horizontal" .....	36
Figure 10: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Koordinimi Vertikal" .....	37
Figure 11: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Koordinimi Horizontal" .....	37
Figure 12: Relevanca për nënfaktorin "Politikat bujqësore" .....	39
Figure 13: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Politikat bujqësore" .....	39
Figure 14: Relevanca për nënfaktorin "Fidanet" .....	42
Figure 15: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Fidanet" .....	42

## Lista e tabelave

Table 1: Sipërfaqja me perime, 2014-2018.....	7
Table 2: Bilanci i furnizimit për specin, 2014-2018.....	8
Table 3: Bilanci i furnizimit për pataten, 2014-2018.....	9
Table 4: Analizimi i hipotezës me T-test.....	38
Table 5: Analizimi i hipotezës me T-test.....	40
Table 6: Analizimi i hipotezës me T-test.....	43

## ABSTRAKT

Qëllimi i këtij hulumtimi është analizimi i gjendjes aktuale dhe përmirësimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e perimeve, specit dhe patateve në veçanti.

Metoda e cila është përdorur në këtë studim është “Metoda e vlerësimit të shpejtë”, e cila ka mundësuar të vlerësojmë zinxhirin e vlerës në mënyrë të përgjithshme për të gjitha hallkat e saj. Studimi bazohet në të dhënat primare dhe sekondare. Të dhënat sekondare na ndihmuan të njihemi më mirë me funksionimin e zinxhirit të vlerës, shoqëruar nga të dhënat primare, të cilave iu parapriu pyetësi i formuluar dhe puna në teren. Mostra për këtë studim është njëzetekatër respondent që janë ekspert të fushës së bujqësisë.

Nga rezultatet e arritura kemi identifikuar zhvillimin dhe ngecjen e faktorëve që ndikojnë në zinxhirin e vlerës, si dhe kemi dhënë rekomandime se si mund të zgjidhet problemi i identifikuar.

Fjalët kyçe: Zinxhiri i vlerës, bujqësia, Kosovë, perime, spec, patate.

## ABSTRACT

The purpose of this study is to analyze the current situation and to improve the performance of the value chain in the vegetable, pepper and potato sector in particular.

The method used in this study is the "Rapid Appraisal Method", which has enabled us to evaluate the value chain in general for its entire links. The study is based on primary and secondary data. Secondary data helped us to become better acquainted with the functioning of the value chain, accompanied by primary data, which were preceded by a formulated questionnaire and the fieldwork. The questionnaire was completed by twenty-four respondents who are experts in the field of agriculture.

From the achieved results we have identified the development and stagnation of the factors that affect the value chain, as well as we have given recommendations on how the identified problem can be solved.

Key words: Value chain, agriculture, Kosovo, vegetables, peppers, potatoes.

# KAPITULLI 1: HYRJJE

## 1.1. Identifikimi i problemit

Të gjithë jemi në dijeni se sa e begatë është Kosova për zhvillimin e bujqësisë, në të gjithë nënsektorët. Kosova ka potencial të rritjes së hortikulturës, pra prodhimin e frutave dhe perimeve, por edhe zhvillimin e nënsektorëve të tjerë. Gjatë viteve të fundit është rritur mbështetja financiare nga institucionet shtetërore dhe shumë donatorë tjerë ndërkombëtarë. Sektori i bujqësisë është duke u zhvilluar dalëngadalë, por shtrohet pyetja nëse janë duke funksionuar të gjitha hallakat e zinxhirit të vlerës?!

Fermerët në Kosovë kanë përvojë në fushën e bujqësisë në përgjithësi dhe për kulturën që ata e kultivojnë. Burimi kryesor i të ardhurave është vet sektori i bujqësisë, në të cilën angazhohen të gjithë anëtarët e familjes. Puna në këtë sektor është përcjellur brez pas brezi, dhe madhësia mesatare e fermave në Kosovë është 3.5 ha për perime. Sa i përket industrisë së përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë, është në rritje dhe në bazë të kapaciteteve të tyre përpunuese, kemi tri kategori përpunuesish: përpunuesit industrial, përpunuesit mesatar dhe përpunuesit e vegjël. Sektori i perimeve kërkon investime më të specializuara dhe të tipit industrial. Tregtarët e zinxhirit të vlerës në Kosovë përbëhet nga shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë. Në rastin e produkteve të freskëta është e zakonshme që fermerët të shesin prodhimin e tyre direkt tek përpunuesit, por ato shpesh shiten edhe përmes shitësve me shumicë. Mekanizmat e qeverisjes që rregullojnë shpërndarjen e produkteve në të gjithë zinxhirin e vlerës janë koordinimi vërtikal dhe ai horizontal. Koordinimi vërtikal përbëhet nga kontratat me shkrim, marrëveshjet verbale dhe pa marrëveshje fare. Nga studimet e mëhershme kemi rezultate se marrëdhëniet e tregut rregullohen kryesisht përmes marrëveshjeve verbale, e që është një mekanizëm i zakonshëm i koordinimit vërtikal mes akterëve. Marrëdhëniet me furnizuesit e inputeve janë joformale, kryesisht të bazuara në pagesa me para në dorë. Koordinimi horizontal tregon bashkëpunimin në mes të akterëve të të njëjtës veprimtari (Miftari, I., 2016). Edhe këtu mund të themi se nuk kemi ndonjë bashkëpunim të prodhuesve mes vete, përpunuesve, qendrave grumbulluese, etj.

Problemi kryesor i përpunuesve të pemëve dhe perimeve është mungesa e lëndës së parë. Kjo në praktikë është duke u shkaktuar nga mospërbushja e kontratave nga ana e fermerëve. Pra,

mungesa e lëndës së parë dhe mospërbushja e kontratave mund të vijnë nga ndryshimet klimatike, dëmtuesit dhe sëmundjet e ndryshme, çmimi, mungesa e punëtorëve, etj.

Kohëve të fundit, respektivisht në vitin 2019, është shfaqur një sëmundje e ashtuquajtur Antraknoza, sëmundje kjo e cila ndikon në uljen e rendimentit dhe cilësisë së specave. Kjo është duke i shqetësuar prodhuesit dhe përpunuesit e kësaj kulture. Problem tjetër është edhe çmimi; në rast se çmimi në treg është më i lartë sesa ai tek përpunuesit, atëherë fermerët, edhe pse kanë kontrata me përpunuesit, gjysmën e prodhimit e shesin në treg ndërsa gjysmën tjetër tek përpunuesit. Në këtë mënyrë nuk përmbushet sasia e kërkuar nga këta të fundit.

Sa i përket varieteteve të specit, speci i kuq, somborkat dhe fafaronat po bëhen problem për sektorin e përpunimit. Kjo për arsye të sëmundjes së lartëpërmendur dhe të mungesës së punëtorëve, veçanërisht për fafarona.

Qendrat grumbulluese furnizohen nga prodhuesit dhe produkti i tyre është i orientuar drejt eksportit, gjë që paraqet problem për furnizimin e përpunuesve me lëndë të parë, në mënyrë që ata të plotësojnë sasinë e kërkuar për prodhimin e produkteve të tyre finale.

Sipas shumë studimeve që janë bërë lidhur me zinxhirin e vlerës vërehet qartë se kemi ngecje në funksionimin e hallkave të saj, nga e cila rezulton një performancë jo e mirë e zinxhirit të vlerës. Nga kjo rrjedhë edhe ideja për një studim tjetër, për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e problemeve të cilat ndikojnë që zhvillimi i mëtutjeshëm i ZV të ngeçë. Ky identifikim i problemeve bëhet nga përgjigjet e respondentëve, të cilët janë ekspertët e fushës përkatëse.

## 1.2. Qëllimi, objektivat dhe hipotezat e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është analizimi i gjendjes aktuale dhe përmirësimi i performancës së zinxhirit të vlerës në përgjithësi dhe në sektorin e perimeve, specit dhe patateve në veçanti.

### Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm është përmirësimi i performancës së zinxhirit të vlerës në sektorin e perimeve (speca dhe patate).

### Objektivat specifike:

1. Identifikimi i faktorëve që ndikojnë në performancën aktuale të zinxhirit të vlerës
2. Vlerësimi mbi rëndësinë e secilës hallkë të zinxhirit të vlerës
3. Analizimi i koordinimit horizontal dhe vertikal
4. Hulumtimi mbi ndikimin e “Mjedisit të përshtatshëm”
5. Dhënia e rekomandimeve nga rezultatet që do të nxirren

## 1.3. Pyetjet hulumtuese dhe hipotezat

### 1.3.1. Pyetjet hulumtuese

Pyetjet hulumtuese për këtë studim janë:

1. Si e vlerësojnë ekspertët kontrollueshmërinë, relevancën dhe peshën e faktorëve të identifikuar në performancën e zinxhirit të vlerës?
2. Specifikoni kontributin pozitiv apo negativ të nënfaktorëve në performancën e zinxhirit të vlerës?
3. Peshojeni aftësinë e secilit nënfaktorë me të cilën ndikon në performancën e faktorit kryesor?
4. Cili është ndikimi i rregullativave të sigurisë ushqimore dhe inspektimit?
5. Sa mirë është i harmonizuar zinxhiri i vlerës përmes koordinimit horizontal dhe vertikal?
6. Cili faktor ambiental ndikon më shumë në përmirësimin e kësaj performance?
7. Çfarë roli kanë pajisjet, inputet dhe kualifikimi i fuqisë punëtore në këtë zinxhir?
8. Cila është rëndësia e menaxhimit në fermë/kompani në këtë çështje?



9. Ku funksionon më mirë zinxhiri i vlerës, te speci apo te patatet?

### 1.3.2. Hipotezat

1. Koordinimi vertikal, në krahasim me atë horizontal ka ndikim më të madh në performancën e zinxhirit të vlerës
2. Politikat bujqësore kanë dhënë kontributin e tyre në performancën e zinxhirit të vlerës
3. Funksionimi i dobët i vetëm një hallke të zinxhirit, ka ndikim në qëndrueshmërinë e kompanisë
4. Bujqësia tradicionale e përdorur në vend, ndikon në prodhimtarinë e perimeve

### 1.4. Rezultatet e pritshme

Nga ky studim kemi pritur të marrim informacionet e sakta, nga hulumtimet e mëhershme dhe nga vet puna në teren. Përmes pyetësorit, kemi pritur të marrim informata, lidhur me atë se si ekspertët e fushës përkatëse, e shohin performancën e zinxhirit të vlerës dhe nxjerrim rezultat mbi gjendjen aktuale të performancës së ZV, nga këndvështrimi i tyre. Përveç kësaj, nga pyetësori, kemi pritur të nxjerrim rezultate, se ku kemi ngecje varësisht nga vlerësimi i faktorëve të identifikuar. Nga Relevanca dhe Pesha, kemi pritur të nxjerrim rezultate lidhur me kontributin dhe aftësinë e nënfaktorëve që japin në performancën sa më të mirë të faktorëve të ZV. Nga ky hulumtim kemi pritur që të përmbushen qëllimi dhe objektivat e këtij studimi.

Përmes rezultateve që do t'i komentojmë nga pyetësori, do të japim rekomandime të cilat do t'iu përgjigjen pyetjeve hulumtuese.

## 1.5. Struktura e punimit

Ky studim, është përqendruar në të dhënat primare dhe sekondare që janë mbledhur gjatë punës së realizuar. Të dhënat primare janë grumbulluar nga pyetësi, që është realizuar me punën në teren nga ekspert të fushës. Ndërsa, të dhënat sekondare, janë grumbulluar nga studime të ndryshme relevante me temën tonë, nga hulumtues, studiues, institucione lokale, shtetërore, organizata të ndryshme, të huaja dhe vendore.

Ky hulumtim përbëhet nga pesë kapituj, ku:

Kapitulli I: Në këtë kapitull flasim për identifikimin e problemit dhe arsyeshmërinë e hulumtimit, e cila shoqërohet me objektivat dhe hipotezat e studimit.

Kapitulli II: Në kapitullin e dytë, lexuesi njihet më shumë me thelbin dhe kuptimin e temës, duke u njoftuar nga studime të ndryshme nga hulumtues të huaj dhe vendor.

Kapitulli III: Kapitulli i tretë është kapitulli në të cilën është përshkruar metodologjia e punës dhe metoda e përdorur për realizimin e hulumtimit. Po në këtë kapitull, lexuesit informohen më shumë për pyetësin e përdorur në punën e terrenit, i cili është i përshkruar në mënyrë të detajuar.

Kapitulli IV: Përmbanë rezultatet dhe të gjeturat nga të dhënat primare, të dhëna këto të cilat janë analizuar dhe përpunuar për të arritur rezultate në lidhshmëri me qëllimin dhe objektivat e studimit. Ky kapitull paraqet rezultate për gjendjen aktuale të funksionimit dhe performancës së zinxhirit të vlerës. Gjithashtu, përbëhet nga dy nënkapituj të ndarë veç e veç, e që edhe analiza për të arritur ato rezultate është e veçantë.

Kapitulli V: Kapitulli i pestë përmbanë sesionin e përfundimeve dhe rekomandimeve. Në këtë kapitull janë përmbledhur të gjitha përfundimet e arritura, nga analiza e rezultateve dhe janë dhënë disa rekomandime, të cilat ndihmojnë në organizimin më të mirë të punës mes akterëve të hallkave të zinxhirit të vlerës.

## KAPITULLI 2: RISHIKIMI MBI LITERATURËN E FUSHËS

### 2.1. Prodhimtaria e perimeve

Në Kosovë, 53% e territorit të saj është tokë bujqësore me madhësi të vogël të fermës (46% me më pak se një hektar) dhe kryesisht bujqësi ekzistuese me nivele të ulëta të investimeve dhe prodhimit. Prandaj, sektori i bujqësisë kontribuon me 12.0% të PBB-së dhe vlerësohet të punësojë rreth 4.6% të fuqisë punëtore. Prodhimi i perimeve është një nga sektorët kryesor të bujqësisë në tërë Kosovën, ndërsa në disa rajone si Lugina e Dukagjinit (veçanërisht rajonet përgjatë lumit Drini i Bardhë) përfaqëson veprimtarinë kryesore ekonomike. Kultivimi në fushë të hapur është praktika mbizotëruese e prodhimit të perimeve. Ekzistojnë disa tendenca, për të përmirësuar asortimentin përmes prezantimit të hibrideve të reja për kulturat bujqësore. Disa tendenca pozitive vihen re në prodhimin e domateve, kastravecit dhe lakrës, ndërsa në lidhje me prodhimin e specave këto përmirësime janë të vogla. Këto ndryshime në prodhimin e perimeve janë të lidhura me traditën e konsumit, sepse disa kultivarë si Somborka dhe K. Kapia janë më të preferuar në konsum (veçanërisht për turshitë ose ushqimet e përpunuara) (Lajqi, S. Thaqi, M. Kaçiu, K. Bytyqi, H. Krasniqi, B., 2017).

Kosova për të përmbushur nevojat vendore për konsum, importon vazhdimisht spec. Tregu i specit në Kosovë është një treg për të cilin ka një kërkesë të madhe, prandaj plasimi i specit në treg nuk paraqet ndonjë problem për kultivuesit e tij. Sasia më e madhe e prodhimit të specit përdoret për konsum njerëzor. Nga prodhimtaria në fermë, një pjesë e vogël përdoret për nevoja familjare dhe pjesa më e madhe shitet në treg. Prodhimi i përgjithshëm vendor mbulon 89% të nevojave të brendshme dhe pjesa tjetër mbulohet nga importi (DAESB, 2015).

Sipërfaqja me perime për vitin 2018 shënon 17,886 ha. Kulturat të cilat dominojnë me sipërfaqe më të mëdha në vitin 2018 janë patatja 3.606 ha dhe speci 3.038 ha (MBPZHR, 2019).

Table 1: Sipërfaqja me perime, 2014-2018

Kultura	2014	2015	2016	2017	2018	Ndryshimi 2018/2017 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>Ha</b>					
Perimet	15,854	14,656	17,395	19,643	17,886	-9
Patate	3,695	3,353	3,795	4,290	3,606	-16
Domate	558	791	866	862	757	-12
Patëllxhan i zi	-	5	4	8	6	-19
Spec	2,553	3,090	3,363	3,035	3,038	0
Kungull	1,354	551	1,017	2,270	2,255	-1
Kungull misiri	232	229	490	684	810	18
Kërpurdha	1	-	-	-	-	-
Trangull	193	317	259	305	273	-10
Shalqi	781	781	1,127	1,201	1,182	-2
Pjepër	167	193	301	388	298	-23
Lakër	556	594	807	917	832	-9
Lulelakër	-	32	83	47	46	-4
Spinaq	139	204	181	161	160	-1
Sallatë	-	59	96	92	78	-16
Panxhar i kuq	58	19	11	-	9	-
Rrepkë (rillkë)	-	2	1	-	5	-
Majdanoz	-	9	13	10	11	6
Presh (purri)	44	78	70	73	72	0
Qepë	1,041	1,079	1,228	1,465	1,185	-19
Hudhër	85	114	140	138	146	6
Fasule	3,959	2,945	3,317	3,406	2,845	-16
Bizele	241	134	96	99	55	-44
Bishtajoret tjera	59	19	30	54	69	28

Karota	76	57	99	107	112	5
Perime tjera	64	-	-	32	37	15

Burimi: ASK – Regjistrimi i Bujqësisë ('14); Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('15, '16, '17, '18)

Kultura e specit merr pjesë me 17%, në gjithsej sipërfaqen e kultivuar me perime. Prodhimtaria sa i përket kulturës së specit për vitin 2018, arrinë 49,907 ton dhe është 21% më e ulët krahasuar me vitin 2017, duke përbushur 82% të nevojave për kosnum. Sasia e importuar e specit ishte 11,524 ton, kurse ajo e eksportuar 582 ton. Vlera e prodhimit të specit për vitin 2018, ishte 43.6mil. €, dhe bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ. Nga gjithsej përdorimi vendor prej 60,850 tonë, për konsum të përgjithshëm janë shfrytëzuar 58,853 ton dhe si humbje llogariten 1,996 ton, ndërsa për përpunim janë destinuar 479 ton (MBPZHR, 2019).

**Table 2: Bilanci i furnizimit për specin, 2014-2018**

Zërat e bilancit	Njësia	2014	2015	2016	2017	2018
Sipërfaqja me perime	ha	15,854	14,656	17,395	19,643	17,886
Sipërfaqja me spec	ha	2,553	3,090	3,363	3,035	3,038
Pjesëmarrja	%	16.1	21.1	19.3	15.4	17.0
Rendimenti	t/ha	22.69	17.95	20.47	20.74	16.43
Prodhimi	t	57,921	55,469	68,849	62,934	49,907
Importi i specit	t	10,489	9,246	11,734	9,692	11,524
Furnizimi	t	68,409	64,715	80,582	72,626	61,431
Eksporti i shpecit	t	994	602	1,113	841	582
Përdorimi vendor	t	67,416	64,114	79,470	71,785	60,850
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	85.9	86.5	86.6	87.7	82.0
Humbjet	t	2,317	2,219	2,754	2,517	1,996
Procesimi	t	556	533	661	604	479
Vetë konsumi final	t	10,565	10,118	12,558	11,479	9,103
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	t	65,099	61,895	76,716	69,267	58,853
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.65	0.70	0.60	0.35	0.91

Vlera e prodhimit	mil.€	36.1	37.3	39.7	21.1	43.6
Bilanci tregtar i specit	mil.€	-4.1	-4.0	-4.2	-3.8	-4.8

Burimi: ASK – Regjistrimi i Bujqësisë ('14); Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('15, '16, '17, '18); ASK, Statistikat e Tresëtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

Patatja merr pjesë me 20% në sipërfaqen e përgjithshme të mbjellur me perime për vitin 2018 me gjithsej 17,886 ha. Sipërfaqja e patates krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rënie për 16%, po ashtu edhe prodhimtaria e patates për vitin 2018 llogaritet 68,790 ton për 45% më e ulët krahasuar me vitin 2017, por prap se prap kjo sasi prodhimi arrin të mbulojë 100% të nevojave të brendshme për konsum. Bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ në vlerë prej 0.5 mil. € duke qenë se çmimi për njësi të importuar është më i lartë sesa çmimi për njësi të eksportuar. Sasia e importit të patates llogaritet 5,930 ton ndërsa ajo e eksportit 11,988 ton.

**Table 3: Bilanci i furnizimit për pataten, 2014-2018**

Zërat e bilancit	Njësia	2014	2015	2016	2017	2018
Sipërfaqja me perime	Ha	15,854	14,656	17,395	19,643	17,886
Sipërfaqja me patate	Ha	3,695	3,353	3,795	4,290	3,606
Pjesëmarrja	%	23.3	22.9	21.8	21.8	20.2
Rendimenti	t/ha	17.33	21.08	25.97	27.56	19.08
Prodhimi	T	64,027	70,678	98,583	118,250	68,790
Importi i patateve	T	4,503	4,822	4,868	5,530	5,930
Furnizimi	T	68,530	75,500	103,451	123,780	74,721
Eksporti i patateve	T	12,673	12,294	14,629	12,822	11,988
Përdorimi vendor	T	55,858	63,206	88,822	110,958	62,733
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	114.6	111.8	111.0	106.6	109.7
Humbjet	T	3,201	3,534	4,929	5,912	3,440
Procesimi	T	3,041	3,357	4,683	5,617	3,268
Vetë konsumi final	T	18,248	20,143	28,096	33,701	19,605
Konsumi i përgjithshëm njerëzor	T	52,656	59,673	83,893	105,045	59,284
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.31	0.33	0.35	0.35	0.33

Vlera e prodhimit	mil.€	18.9	22.2	32.8	39.3	21.6
Bilanci tregtar të patates	mil.€	-0.2	-0.4	-0.2	-0.5	-0.5

Burimi: ASK – Regjistrimi i Bujqësisë ('14); Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('15, '16, '17, '18); ASK, Statistikat e Tregëtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZHR

Kosova ka një potencial mjaftë të mirë, për kultivimin e specit, për shkak të klimës së favorshme, prandaj edhe kultivohen në fushë të hapur. Kultivimi i specit është i përqendruar në rajonin e Dukagjinit, i cili karakterizohet me klimë më të butë krahasuar me rrafshin e Kosovës. Prodhimi vendor i specit, është i gatshëm për treg gjatë muajve korrik dhe shtator. Gjatë të njëjtës periudhë është i theksuar edhe eksporti, i cili kryhet edhe nga pikat grumbulluese, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në zinxhirin e vlerës. Speci i përpunuar gjithashtu paraqet një vlerë të shtuar të produktit, të cilin e gjejmë në treg në formë të turshive, ajvarit dhe në formë të perimeve të ngrira. Speci përpunohet nga njësitë përpunuese të specializuara, por edhe në kushte shtëpiake (AGRO.RECURA, 2019). Tregu i specit në Kosovë është një treg për të cilin ka një kërkesë të madhe, prandaj plasimi i specit në treg nuk paraqet ndonjë problem për kultivuesit e tij. Në tregun tonë janë të pranishme disa lloje të specave duke përfshirë specat somborka, specat të ajvarit, feferonat, specat e djegës, specat e kuq, baburet dhe specat pa djegës (DAESB, 2015).

Kosova gjithashtu importon spec të freskët dhe të përpunuar për furnizim të tregut vendor. Sasia më e madhe e importit të specit është gjatë muajve Prill-Qershor, ndërsa në muajin Korrik fillon të bie sasia e importit dhe kjo si rezultat i pranisë së prodhimitarisë vendore. Nga muaji Korrik, Kosova gjithashtu fillon të eksportoje një sasi të specave, ku sasia më e madhe është gjatë muajit Shtator, kur prodhimtaria vendore arrin vlerat më të larta. Gjithashtu, eksporti ka filluar të realizohet në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, ku dërgohet kualiteti më i lartë i specit të freskët por edhe specit të përpunuar, i cili kryesisht shitet tek diaspora (AGRO.RECURA, 2019) (DAESB, 2015).

Patatja në Kosovë kultivohet dhe konsumohet në një masë të madhe dhe në forma të ndryshme. Për t'i përmbushur nevojat për konsum vendi ynë importon një sasi shumë të vogël të patates ngase prodhimtaria vendore përmbush rreth 95% të kërkesave vendore (DAESB, 2015).

Prodhimi i specave është i dominuar nga fermat e vogla që llogaritet të prodhojnë 64% të totalit të specave, të ndjekura nga fermat gjysmëkomerciale (30%) dhe fermave komerciale (6%). Përdorimi total vendor i perimeve, në veçanti domateve, specave dhe patateve, është rritur në dy

vitet e fundit (2017-2018), dhe pritjet të rritet më shumë si rezultat i rritjes së fuqisë blerëse të konsumatorëve dhe shprehive të shëndetshme të konsumit. Sipas Planit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, konsumimi vjetor i perimeve të freskëta për kokë banori në Kosovë llogaritet të jetë 146 kg, që është më e ulët sesa ajo në rajon – Shqipëria (173 kg/kokë banori), Bosnja e Hercegovina (168 kg/kokë banori) dhe Maqedonia e Veriut (156 kg/kokë banori). Ndërsa, konsumimi i perimeve të përpunuara, krahasuar me perimet e freskëta, në Kosovë është më i ulët – 1.5 kg/kokë banori (BE 8-12 kg/kokë banori) (Fischer, CH., 2002) (Miftari, I., 2019). Prodhimi i perimeve, sidomos në fushë të hapur, mbetet i vogël dhe kjo mund të jetë si rezultat i strukturave të fermave – fermat me madhësi të vogël me fragmentim të lartë të tokës dhe teknologji të vjetëruar të prodhimit (Miftari, I., 2019). Zonat e kultivuara me specat u zgjeruan, por ky zgjerim nuk u shoqërua me rritje të rendimentit. Rendimentet e ulëta janë rezultat i përdorimit të teknologjisë tradicionale të kultivimit, varieteteve të farës së specave dhe fidaneve me cilësi të ulët (Kaçiu, S., 2008).

## **2.2. Zinxhiri i vlerës së bujqësisë në Kosovë**

Zinxhirët e vlerës së ushqimit, përfshijnë të gjitha aktivitetet e nevojshme, për të sjellë produkte bujqësore te konsumatorët, përfshirë prodhimin bujqësor, përpunimin, magazinimin, tregtimin, shpërndarjen dhe konsumin (Gomez, M. Ricketts, K., 2013). Një zinxhir i vlerës mund t'i referohet një tregu të caktuar të konsumit, ose një tregu të caktuar të lëndës së parë. Sipas Kaplinksy & Morris (2000) “Zinxhirët e Vlerës përshkruajnë gamën e plotë të aktiviteteve, të cilat kërkohen për të sjellë një produkt ose shërbim nga koncepti, përmes fazave të ndryshme të prodhimit (duke përfshirë një kombinim të transformimit fizik dhe shërbimeve të ndryshme të prodhuesit), dorëzimi te konsumatorët e fundit dhe asgjësimi përfundimtar pas përdorimit” (Attaie H. Fourcadet O., 2003).

Akterët kryesor të zinxhirit të vlerës në Kosovë janë fermerët, përpunuesit, tregtarët dhe furnizuesit e inputeve. Madhësia mesatare e familjeve fermere është relativisht e lartë, përkatësisht 8 anëtarë. Madhësia mesatare e fermës për perime është 3.5ha dhe shumica e fermerëve janë të pajisur me mekanizma bujqësor dhe mjete transportuese.



Sa i përket kapaciteteve të magazinimit (ruajtjes), në rastin e perimeve, është e zakonshme që të ketë magazinim, sepse sidomos në rastin e patateve, ata janë në mënyrë tipike për periudha më të gjata. Importet e larta të perimeve, nga vendet fqinje sjellin furnizim të lartë, veçanërisht për speca, e cila drejton çmimet poshtë, dhe kjo së bashku me mungesën e kapaciteteve të duhura dhe të gjera të magazinimit i bën humbjet pas korrijës edhe më të larta. Vlera të ndryshme janë raportuar për humbjet e perimeve (13.4% për patate dhe 18.7% për speca) (Miftari, I., 2016).

Konsumatorët në zinxhirin tradicional të vlerës agro-ushqimor, ndjekin modele afatgjata dhe më shpesh blejnë ushqim direkt nga fermerët dhe tregtarët në marketet regjionale dhe lokale. Disponueshmëria e produkteve në zinxhirin tradicional të vlerës agro-ushqimor tenton të jetë sezonale (Gomez, M. Ricketts, K., 2013).

Duke parë situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 shohim se kemi një ndryshim të madh të krijuar nga kjo kohë. Sipas studimit të Odave Ekonomike rezultoi se në sferën e prodhimit, 36.6% të ndërmarrjeve të anketuara kanë ndërprerë veprimtarinë tërësisht, 39.2% punojnë me kapacitete të reduktuara, kurse 13.7% punojnë me orar të shkurtuar (Odat Ekonomike, Këshilli i Investitorëve Evropian, Klubi i Prodhuesve të Kosovës, 2020).

Në mënyrë figurative, është paraqitur zinxhiri i vlerës, në figurën më poshtë, duke përfshirë funksionet kryesore, vertikalisht nga poshtë-lartë. Funksionimi i koordinimit vertikal dhe horizontal mundëson kalimin e produktit, nëpër të gjitha hallkat e zinxhirit të vlerës, duke i shtuar vlerë produktit derisa arrijnë te konsumi final (AGRO.RECURA, 2019).




Figure 1: Akterët kryesor të zinxhirit të vlerës

Burimi: Udhëzues për kulturën bujqësore: Speci, RECURA

### 2.2.1. Përpunuesit

Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve në Kosovë, është në rritje dhe teknologjia e saj përpunuese është duke u përmirësuar. Në bazë të kapaciteteve të tyre përpunuese, ka tre kategori përpunuesish:

1. Përpunuesit industrial,
2. Përpunuesit mesatar dhe
3. Përpunuesit e vegjël.

Sektori i perimeve, kërkon investime më të specializuara dhe të tipit industrial (Miftari, I., 2016).

Sipas studimit të (PPSE, 2014) ku janë intervistuar 10 përpunues të pemëve dhe perimeve në Kosovë, rezulton se 4 prej tyre i janë dedikuar vetëm përpunimit të perimeve dhe 1 i është dedikuar vetëm përpunimit të pemëve; kurse 5 kompani të tjera, i janë dedikuar të dyja grupeve të produkteve, edhe pse dy përpunues të vegjël kryesisht përpunojnë perime. Gjithashtu, nga ky studim rezulton se përpunuesit vendor në Kosovë, bashkëpunojnë drejtëpërdrejtë me shitësit me pakicë dhe shumë pak me shitësit me shumicë. Përpunuesit, si respodent të këtij studimi, raportuan se mesatarisht 70% e të gjithë prodhimit, shitet drejtëpërdrejtë tek shitësit me pakicë, afërsisht 20% të prodhimit është në tregun përmes shitësve me shumicë, kurse pjesa e mbetur e prodhimit i shitet drejtëpërdrejtë sektorit të hotelerisë.

Sipas studimit (Lajqi, S. Thaqi, M. Kaçiu, K. Bytyqi, H. Krasniqi, B., 2017) tregohet se industria e përpunimit të perimeve në Kosovë, ka një traditë të gjatë. Mirëpo përkundër këtij fakti, në Kosovë, nuk ka prodhim të specializuar për përpunim. Madje, gjatë gushtit dhe shtatorit në kulmin e prodhimit të specit, është e pamundur, që kompanitë përpunuese të thithin të gjitha sasi të prodhuara të specit nga fusha, edhe pse kapacitetet përpunuese janë të larta.

### 2.2.2. Tregtarët

Tregtarët në zinxhirin e vlerës së Kosovës, përbëhen nga shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë. Në rastin e produkteve të freskëta për përpunim, është më e zakonshme që fermerët t'i shesin direkt tek përpunuesit, por, ato shpesh shiten edhe përmes shitësve me shumicë (Miftari, I., 2016). Gjithashtu, edhe studimi (DAESB, 2015) tregon se tregu me shumicë, furnizohet kryesisht nga fermerët, të cilët nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje me qendrat grumbulluese apo

kompanitë përpunuese. Sipas (Stafa, A., 2018), tregtarët me shumicë kanë rol kyç në shpërndarjen ose tregtinë, pra janë ura kryesore lidhëse midis fermerëve dhe tregtisë me pakicë.

Sa i përket tregut me pakicë, ajo përbëhet nga disa pronësi në nivel lokal, duke zgjeruar zinxhirin e supermarketeve, dyqaneve të vogla dhe tregjeve të gjelbra (Miftari, I., 2016). Zinxhirët e shitjes me pakicë në Kosovë veprojnë në tri kategori kryesore: 1. Hipermarkete të mëdha (me deri në 20,000 produkte); 2. Supermarkete të mesme (me deri në 10,000 produkte) dhe 3. Tregjet e dyqaneve me madhësi të vogël (me deri në 5,000 produkte). Zinxhirët e shitjes me pakicë, veçanërisht hipermarketet e mëdha, janë krijuar në fillim të vitit 2000 (USAID, 2007), ndërsa zinxhiri i shitjes me pakicë me dyqane me madhësi të mesme dhe të vogël janë krijuar rreth vitit 2010. Ka rreth 10 zinxhirë kryesorë të shitjes me pakicë në Kosovë, që luftojnë për të fituar pjesën e tregut nga njëri-tjetri (PPSE, 2017).

Por, sipas studimit të (Stafa, A., 2018) supermarketet luajnë akoma një rol të vogël në tregjet e frutave të freskët dhe perimeve. Gjithashtu sipas tij, zinxhiri i vlerës agro-ushqimore pritet të ndryshojë ndjeshëm në vitet e ardhshëm, sepse pjesa e supermarketeve në sektorin e pakicës, pritet të rritet ndjeshëm dhe ndryshimet sociale-demografike dhe integrimi në BE imponojnë më shumë presion, për rregullimin dhe përmbushjen e standardeve të sigurisë dhe cilësisë.

Studimi (PPSE, 2014) paraqet se në nivelin e shitjes me pakicë në Kosovë, pjesëmarrja e perimeve të përpunuara në shitjet totale, ndryshon konsiderueshëm nëpër zinxhirë të shitjes me pakicë. Pjesëmarrja e perimeve të përpunuara në shitjet totale sillet ndërmjet 0.5% dhe 12%, me një pjesëmarrje mesatare prej 3.5% për shitës me pakicë.

### **2.2.3. Furnizuesit e inputeve**

Furnizuesit e inputeve kanë të bëjnë me furnizimin e farave dhe plehrave, pajisjeve bujqësore, tubat e ujitjes, petë plastike, lidhjet, polet e metalit dhe betonit, etj. Ka rreth 150 furnizues me agro-kemikate në Kosovë, nga të cilat 3 ose 4 janë të njohur shumë mirë në secilin rajon (Miftari, I., 2016).

Shumica e furnizuesve të inputeve, mundësojnë edhe shërbime këshilluese për mbjellje, krasitje, mbrojtje të bimëve dhe kërkesave të tjera të veçanta, të cilat këshillime dhe shërbime jepen zakonisht gjatë blerjes së produktit (AGRO.RECURA, 2019).

*Farërat e perimeve* – blehen kryesisht nga shitësit e tjerë dhe zakonisht nga vende të ndryshme, si p.sh.: Serbia, Maqedonia, Sllovenia, etj (Miftari, I., 2016). Perzgjedhja e farërave nga fermerët është e larmishme. Në disa raste (në rajonet e prodhimit si Anadrini dhe Lugu i Baranit), 30 deri në 40% të farërave prodhohen nga fermerët. Kjo ndodhë veçanërisht me varietetet Somborka dhe K.Kapia. Si fillim, prodhuesit zgjedhin frutat më të mira dhe më të shëndetshme, e më pas ata heqin farat dhe i thajnë në diell. Më vonë, farat ruhen diku në fermë, pa ndonjë kriter specifik të ruajtjes. Farat e prodhuara në këtë mënyrë nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli ose trajtimi parambjelljes. Padyshim, të gjitha këto mangësi të përmendura ndikojnë ndjeshëm në rendimentin e specit dhe kohën e korrjes përfundimtare (Kaçiu, S., 2008).

*Fidanet* – shumica e fermerëve që kultivojnë specja janë duke prodhuar fidanet e tyre me metodën tradicionale, në serra të vogla ose tunele. Por, shumica e fermerëve furnizohen me fidane nga fidanishtet që janë avancuar në aspektin teknologjik të kultivimit të fidaneve, duke u financuar nga donatorë të ndryshëm të huaj.

*Plehrat dhe Pesticidet* – këto inpute importohen me përjashtim të plehurat organik. Është një numër i vogël i importuesve të plehrave, kryesisht nga: Serbia, Maqedonia e Veriut, Greqia, Austria dhe Ukraina. Pesticidet janë të importuara nga rajoni i Ballkanit dhe nga ai i BE-së, ndërsa ka disa kompani që furnizohen me pesticide nga Jordani dhe disa shtete të Lindjes së Mesme. Kompanitë zakonisht janë përfaqësues të kompanive shumë të njohura, si: Bayer nga Gjermania, Pegasi nga Jordania (Miftari, I., 2016).

#### **2.2.4. Koordinimi Horizontal dhe Vertikal**

*Koordinimi horizontal* – Koordinimi horizontal tregon bashkëpunimin në mes të akterëve të të njëjtës veprimtari. Sipas studimit të (Miftari, I., 2016) shumica e akterëve nuk janë pjesë e ndonjë grupi prodhuesish bujqësor apo kooperativave, e gjithashtu pjesmarrja e tyre varet nga ekzistenca e organizatave në fjalë. Studimi ka analizuar dhe kuptuar se, iniciativat dhe gatishmëria e fermerëve për bashkëpunim, varet nga përceptimet e fermerëve mbi konkurrencën e

produktit për shitje. Si rezultat i studimit del se, për shumicën e fermerëve, lidhjet personale janë shumë të rëndësishme për fillimin e bashkëpunimit.

*Koordinimi vertikal* – Mekanizmi i koordinimit vertikal përbëhet nga kontratat me shkrim, marrëveshjet verbale dhe pa marrëveshje fare. Rezultatet sipas studimit të (Miftari, I., 2016) raportojnë se marrëdhëniet e tregut, rregullohen kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve verbale, të cilat janë një mekanizëm i zakonshëm i koordinimit vertikal. Kontratat me shkrim janë duke u bërë të pranishme gjithnjë e më shumë mes shitësit me shumicë dhe përpunuesve, por kjo është e përcaktuar edhe nga lloji i produktit. Pastaj, marrëdhëniet me furnizuesit e inputeve janë kryesisht joformale, të bazuara me para në dorë (cash-based). Sipas këtij studimi tregohet se mungesa e traditës në përdorimin e kontratave me shkrim, është faktori kryesor që përcakton përdorimin e kontratave me shkrim në të tashmen. Ndërsa, sa i përket çmimit, mekanizmat kryesor për përcaktimin e çmimit, janë tregjet (çmimet e importit dhe eksportit), furnizimit të produktit, kostot dhe margjinat e fitimeve për secilin akter. Fermerët, janë vetë ata që kanë ndikim në çmim, vetëm për shitje të drejtëpërdrejtë te konsumatorët. Mirëpo, kur shesin te akterët e tjerë në zinxhirin e vlerës, si te shitësit me pakicë, shumicë dhe te përpunuesit, çmimi diktohet kryesisht nga akterët e fundit. Mënyra e pagesës është e dominuar nga pagesat në para të gatshme (mbi 80%), kurse pjesa tjetër përmes transferit bankar. Nga kjo kuptohet se pjesa më e madhe e pagesës është bërë me para në dorë, prandaj edhe marrja e parave është bërë në vend, në të njëjtën ditë. Koha e pagesës është e lidhur me kohën kur është porositur produkti.

### **2.2.5. Mjedisi i përshtatshëm**

“Mjedisi i përshtatshëm” përbëhet nga politikat, institucionet dhe shërbimet mbështetëse që formojnë vendosjen e një kornize të përgjithshme, sipas së cilës ndërmarrjet krijohen dhe veprojnë. Pra, është një nga përcaktuesit kryesorë të performancës së zinxhirit të vlerës. Varësisht se si është e rregulluar, ajo mund ta mbështesë ose ta dëmtojë punën e një zinxhiri agroushqimor. Në rastin e Kosovës, sipas studimit të (Miftari, I., 2016) tregohet se një nga pengesat kryesore të raportuara nga responentët ishte cilësia e ulët e farërave. Nga totali i responentëve, 77.7% e prodhuesve të perimeve raportojnë se tregtarët e çertifikuar janë furnizuesit e tyre kryesorë me farë/fidane. Dhe sa i përket plehrave, 93.3% e prodhuesve të

perimeve, raportuan se tregtarët e çertifikuar janë furnizuesit e tyre kryesor, me plehra dhe inpute të tjera.

Ekziston Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural ( Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, 2009), i cili ka për qëllim përcaktimin e politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural. Në vitin 2012, (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, 2012), është bërë ndryshimi i ligjit në fjalë, në zëvendesimin e fjalëve dhe neneve të ligjit.

(Qeveria e Republikës së Kosovës, 2020) tregon se politikat e qeverisë, në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, do të fokusohen në tri aspekte kryesore: 1. Rritjen e produktivitetit përmes avancimit të politikave; 2. Investimet në infrastrukturë; 3. Inovacion në bujqësi. Në sektorin e bujqësisë, do të riorganizohet skema e subvencioneve dhe skema e granteve, bazuar në kritere të qarta dhe transparencë të plotë, duke u fokusuar në rendiment e jo në sipërfaqe – konform rrethanave ekzistuese, për rritjen e produktivitetit dhe cilësisë, që rezulton në rritje të konkurrueshmërisë. Investimet infrastrukturore në mbështetje të sektorit të bujqësisë, duhet të fokusohen në dy drejtime: sistemet e ujitjes së tokave bujqësore, ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor të zonave rurale. Sa i përket inovacionit, qeveria do t'i kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të teknologjisë informative, si një formë ndërlidhëse e vendit me ekonominë rajonale dhe globale.

### **2.3. Zinxhiri Global i Vlerës**

Zinxhiri global i vlerës, është zhvilluar në vitet 1990 dhe 2000, por zhvillimi i saj është ngadalësuar që nga kriza ekonomike e vitit 2008. Kjo krizë financiare dhe ngadalësimi ekonomik si pasojë, bllokuan evolucionin e zinxhirit global të vlerës agro-ushqimore dhe pandemia COVID-19 mund të prishë më tej, potencialin e tyre në tregtinë globale dhe rritjen ekonomike. Teknologjitë dixhitale po transformojnë të gjitha fazat e zinxhirit agro-ushqimor të vlerës – nga ferma në tryezë. Ato përmirësojnë efikasitetin, krijojnë vende pune dhe kursejnë resurset. Por, është e vështirë të parashikosh të gjitha ndikimet që mund të ketë inovacioni teknologjik në mënyrën se si rritemi, përpunojmë, tregtojmë dhe konsumojmë ushqim. Nga viti 2000 deri në vitin 2007, zinxhiri global i vlerës, veçanërisht ato komplekse, po zgjeroheshin me një ritëm më të shpejtë sesa përbërësit e tjerë të PBB-së. Gjatë krizës financiare globale natyrisht ka pasur një pakësim të ZGV, pasuar nga rimëkëmbja e shpejtë (2010-2011), por që atëherë, me përjashtim të

vitit 2017, rritja, kryesisht, është ngadalësuar. Një nga arsyet është rritja dhe investimi i vogël në ekonominë globale. Ajo është një seri e fazave të prodhimit të produktit, ose shërbimit për ta shitur te konsumatori. Secila fazë, shton vlerë dhe së paku dy prej tyre janë në shtete të ndryshme. Zinxhiri global i vlerës ka rëndësi të madhe në zhvillim. Tregtia e zinxhirit global të vlerës shfaqë dy karakteristika që e dallojnë atë nga tregtia tradicionale: hiperspecializimi dhe marrëdhëniet e qëndrueshme midis firmave (World Bank Group, 2020) (World Trade Organization, 2019) (FAO, 2020).

Hiperspecializimi dhe marrëdhëniet e qëndrueshme midis firmave, nxisin prodhimin efikas dhe përhapjen e teknologjisë, si dhe aksesin në kapital dhe inputet përgjatë zinxhirëve të vlerës. Rezultati është rritja e produktivitetit dhe të ardhurave më shumë sesa ajo që vendet arrijnë përmes prodhimit të brendshëm, por edhe nga ajo që arrijnë përmes tregtisë së mallrave të gatshme (World Bank Group, 2020).

Më shumë se dy e treta e tregtisë botërore, tani ndodh përmes zinxhirit global të vlerës. Gjatë dy dekadave të fundit, ZGV kanë zvogëluar barrierat tregtare, kanë ulur kostot e transportit, kanë krijuar vende pune për punëtorët dhe kanë nxitur rritje të konsiderueshme ekonomike në vendet në zhvillim (World Trade Organization, 2019). Drejtori i Përgjithshëm i FAO-s thotë se zinxhirin global të vlerës, mund ta bëjnë më të lehtë për vendet në zhvillim, për tu integruar në tregjet globale. Ndërsa lidhin tregjet tona më afër, ato gjithashtu ofrojnë një mekanizëm për shpërndarjen e praktikave më të mira, për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm (FAO, 2020).

Si përmbledhje, ndryshe nga tregtia tradicionale ndërkombëtare, transaksionet e të cilave përfshijnë vetëm dy vende (një vend eksportues dhe një vend importues), tregtia e ZGV kalon kufijtë shumë herë. Kjo qasje ndaj tregtisë, jo vetëm që çon në një grup të pasur përcaktuesish dhe pasojash të pjesëmarrjes së ZGV, por gjithashtu krijon sfida për matjen e aktivitetit të ZGV në botë. Sfida kryesore në matjen e vlerës së shtuar në një ZGV, lind nga fakti se të dhënat doganore, burimi standard për flukset tregtare ndërkombëtare, japin informacion se ku është prodhuar malli ose shërbimi i kryer, por jo se si është prodhuar – d.m.th., cilat vende kontribuan me vlera në të. Në mënyrë të ngjashme, të dhënat doganore regjistrojnë se ku po kalon malli i transaksionuar, por jo se si do të përdoret - d.m.th., nëse do të konsumohet plotësisht në vendin importues, ose nëse do të riekportohet pasi vendi importues të shtojë vlerën tek ajo.



Në zinxhirin global të vlerës të gjitha vendet marrin pjesë, por pjesëmarrja e tyre është e pabarabartë. Disa vende eksportojnë lëndë të parë për përpunim të mëtejshëm; të tjerët importojnë inputet për montim dhe eksport; dhe akoma të tjerët prodhojnë mallra dhe shërbime komplekse. Për më tepër, disa varen shumë nga ZGV për tregti, ndërsa të tjerët eksportojnë kryesisht mallra vendore për konsum. Për të kapur këto tipare të dallueshme të pjesëmarrjes, vendet klasifikohen në katër lloje kryesore - mallra, prodhim i kufizuar, prodhim i avancuar dhe shërbime, si dhe aktivitete inovative - bazuar në produktet që eksportojnë dhe pjesëmarrjen e tyre në ZGV (World Bank Group, 2020).

Megjithëse ZGV në sektorët e bujqësisë dhe ushqimit janë zgjeruar gjatë dy dekadave të fundit, ato mbeten një pjesë e vogël e tregtisë së ZGV. Në vitin 2014 eksportet e bujqësisë përbënin 2 përqind të eksporteve botërore; Azia, Amerika Latine dhe Afrika Sub-Sahariane panë hyrjet e investimeve të huaja direkte (IHD) në sektorin agro-ushqimor të rriteshin me një faktor tre, midis viteve 2000 dhe 2010. Por, investime të tilla janë kryesisht në tregje të mëdha dhe më të zhvilluara brenda Amerikës Latine (Argjentina, Brazili, Kili dhe Meksika) dhe Azisë (Kina, Indonezia dhe Vietnami), më pak që rrjedhin në Afrikën Nën-Sahariane (Etiopia, Gana, Tanzania dhe Uganda). Këto investime kryesisht kanë për qëllim industrinë ushqimore (përpunimin dhe shitjen me pakicë) në vend të bujqësisë. Më e rëndësishmja, pjesëmarrja e shumicës së vendeve në zhvillim në zinxhirin global të vlerës së sektorit të bujqësisë dhe ushqimit, është kryesisht përpara, sepse është e kufizuar në furnizimin e një produkti specifik, si p.sh.: kafe nga Etiopia ose Uganda, kakao nga Bregu i Fildisht ose Gana, portokall nga Brazili, dhe banane nga Kolumbia (World Bank Group, 2020).

Përmes ZGV, vendet tregtojnë më shumë sesa vetëm produktet; ata tregtojnë njohuri teknike dhe i bëjnë gjërat së bashku. Importet e mallrave dhe shërbimeve kanë rëndësi po aq sa eksportet në suksesin e zinxhirit global të vlerës. ZGV integrojnë njohuritë teknike, të firmave kryesore dhe furnizuesve, të përbërësve kryesorë, përgjatë fazave të prodhimit dhe në vende të shumta në det të hapur. Rrjedha ndërkombëtare e ndër-firmës e njohurive teknike është tipari kryesor dallues i ZGV. Zinxhiri global i vlerës është një nxitës i fuqishëm i rritjes së produktivitetit, krijimit të vendeve të punës dhe rritjes së standardeve të jetesës. Vendet që e përqafojnë atë, rriten më shpejt, importojnë shkathtësitë dhe teknologjinë, si dhe rrisin punësimin. Me zhvillimin e drejtuar nga ZGV, vendet gjenerojnë rritje duke kaluar në detyra me vlerë të shtuar më të lartë

dhe duke vendosur më shumë teknologji dhe njohuri teknike, në të gjithë prodhimin e tyre të bujqësisë, industrisë përpunuese dhe shërbimeve. ZGV i ofron vendeve mundësinë për të kaluar procesin e tyre të zhvillimit. Fushat e Praktikave Globale dhe Zgjidhjeve Ndërsektoriale të Grupit të Bankës Botërore, ndihmojnë vendet kliente, të hartojnë dhe zbatojnë reforma efektive, të orientuara drejt zgjidhjeve. Grupi i Bankës Botërore ofron zgjidhje të integruara, të përshtatura për nevojat e vendit. Shërbimet këshilluese dhe mbështetja financiare - përfshirë huazimin e politikave të zhvillimit për qeveritë, investimet në sektorin privat dhe garancitë e MIGA - mund të mbulojnë strategji afatgjata, për reformë të thellë strukturore ose mbështetje për ndërhyrje më të synuara të politikave që adresojnë sfida afatshkurtra. Qeveritë duhet të kenë një vizion dhe mandat të qartë për të përmirësuar përfshirjen e sektorit privat. Hapja e kufijve dhe tërheqja e investimeve mund të ndihmojë hyrjen e shpejtë në ZGV. Vendet do të nxjerrin përfitimin më të madh, duke maksimizuar potencialin thithës të ekonomisë së brendshme dhe duke forcuar lidhjet e saj me ZGV (World Bank Group).

Zinxhiri global i vlerës në sektorin e bujqësisë, karakterizohet gjithashtu nga mbizotërimi i informalitetit, i cili ka pasoja të rëndësishme për varfërinë dhe cënueshmërinë e punëtorëve. Në vendet në zhvillim, mbi 94% e punësimit në bujqësi, është joformale kundrejt 63% në prodhim. Megjithëse firmat e përfshira në ZGV paguajnë paga të larta për punëtorët e tyre zyrtarë, ata gjithashtu mbështeten shumë tek punëtorët informal, të cilët nuk fitojnë të njëjtat parime (World Bank Group, 2020).

## **2.4. Metoda e vlerësimit të shpejtë**

Metoda e vlerësimit të shpejtë (Rapid appraisal “RA”) është veçanërisht tërheqëse për përpjekjet e kërkuara kërkimore, të tilla si analiza e zinxhirit të vlerës. Përparësitë janë përshtatshmëria ndaj natyrës së informacionit të kërkuar, efikasiteti në kohë i proceseve të mbledhjes së informacionit dhe kosto të ulëta, kur krahasohen me alternativa më të zyrtarizuara. Përkrahësit e metodave RA argumentojnë, se ato janë të forta në adresimin e nevojave të informacionit, në lidhje me përceptimet, shqetësimet, vlerësimet dhe qëndrimet e palëve të interesuara (Carlos A. da Silva, Hildo M. de Souza Filho, 2007). Pesë metoda, janë identifikuar si thelbi i metodologjisë së vlerësimit të shpejtë: intervistat kryesore informuese, diskutimet në fokus grupe, intervistat e

komunitetit/grupit, vëzhgimi i strukturuar i drejtpërdrejtë, anketimet informale (World Bank, 1993) (Carlos A. da Silva, Hildo M. de Souza Filho, 2007).

Kjo metodë e vlerësimit të shpejtë mund të ndihmojë në mbledhjen, analizimin dhe raportimin e informacionit përkatës, për vendimmarrësit brenda ditëve ose javëve (Gilbeaux, 2012). Gjithashtu, është një nga vlerësimet që profesionistët urban dhe të huaj të mësojnë, në një periudhë të shkurtër, të kufizuar, për një komunitet, zonë, aktivitet ose një problem specifik që ata mendojnë se nuk dinë mjaftueshëm. Ajo përshkruan një raport të qasjeve të shpejta për mbledhjen e informacionit dhe jo një metodologji fikse, të caktuar (Townesley, 1993) (Pattanayak).

Parimi më i rëndësishëm për të kuptuar në lidhje me vlerësimin e shpejtë (rural) (RRA) është se kjo nuk është një metodologji e mbledhjes së informacionit, në vetvete, por një përdorim krijues, i strukturuar i një grupi të veçantë të mjeteve hetimore, për vlerësimin e një situatë, teme, problemi ose sektori. RRA dhe paketa e saj e mjeteve, mund të përshkruhen, si një proces i shpejtë i të mësuarit - duke krijuar në mënyrë kreative mjetet e shkencës sociale, për mbledhjen dhe analizimin e informacionit. Ekipet që përdorin mjete të tilla, janë në gjendje të vlerësojnë praktikatat e menaxhimit të burimeve natyrore dhe çështjet në lidhje me përmirësimin e tyre, në një mënyrë më të saktë dhe me kosto - mënyrë efektive sesa me metodat konvencionale të hetimit (FAO).

## KAPITULLI 3: METODOLOGJIA DHE METODAT E HULUMTIMIT

### 3.1. Metodologjia e aplikuar

Studimi është realizuar nga hulumtimi në zyrë, i cili i paraprinë formulimit të pyetësorit dhe punës në teren. Për t'i plotësuar objektivat e studimit, së pari është dashur të hulumtojmë dhe të njoftohemi më shumë, rreth zinxhirit të vlerës në sektorin agrorshqimor në Kosovë. Për t'i dhënë jetë këtij studimi janë përdorur të dhënat cilësore dhe sasiore; ku të dhënat cilësore i kemi siguruar nga hulumtimi i raporteve relevante me temën tonë nga hulumtues e ekspert të ndryshëm vendor dhe të huaj. Të dhënat sasiore, janë siguruar nga realizimi i punës në teren, ku kemi fituar vlerësimin për gjendjen aktuale, të zinxhirit të vlerës nga këndvështrimi i ekspertëve.

Metoda e cila është përzgjedhur për këtë studim quhet “metoda e vlerësimit të shpejtë”, e shoqëruar nga pyetësori dhe puna në teren. Bazohet në identifikimin dhe analizën e faktorëve kryesor të performancës së zinxhirit të vlerës.

Target grupi, për studimin tonë kanë qenë ekspertët e fushës përkatëse, të cilët kanë pasur mundësinë të vlerësojnë, kontributin dhe aftësinë e çdo nënfaktori në performancën e faktorëve kryesor; e që këta faktorë pastaj kontribuojnë në performancën e zinxhirit të vlerës në sektorin agrorshqimor në Kosovë.

Për këtë studim janë intervistuar gjithësej 24 ekspert, që përfshinë zyrtarë të institucioneve të ndryshme përkatëse (MBPZHR, USAID, GIZ); profesor; udhëheqës të kompanive agrorshqimore, respektivisht të perimeve; drejtues të pikave grumbulluese; si dhe përfaqësues të barnatoreve bujqësore. Programi statistikor që është përdorur është programi Exel, e cila na mundëson shfaqjen më të mirë të statistikave në grafe dhe figura të ndryshme.

Sa i përket modeleve ekonometrike, është përdorur modeli i t-testit, i cili na mundësoi t'i përpunojmë të gjitha të dhënat primare, nga puna e terenit dhe t'i vërtetojmë hipotezat e parashtruara në këtë studim.

### 3.1.1. Informata lidhur me pyetësin

Pyetësi është rezultat i metodës së ashtuquajtur “metoda e vlerësimit të shpejtë” dhe është i formuluar në atë mënyrë që na lejon të përmbushim objektivat specifike të studimit. Metoda në fjalë ndahet në 3 faza, gjë që na kushtëzon që pyetësi ynë të ketë vetëm 3 pyetje themelore. Pyetjet janë të mbyllura, sepse respondentit detyrohet të japë përgjigje vetëm me vlerat e përcaktuara nga metoda në fjalë (shiko aneksin).

Së pari, janë identifikuar faktorët kryesor dhe pastaj këto i kemi zbrëthyer në disa elemente përbërëse të tyre, që ne i quajmë “nënfaktorë”, e që na lejojnë vlerësimin objektiv të ndikimeve të tyre në performancën e sistemit. Kjo metodë është e ndarë në 3 faza:

1. Identifikimi i faktorëve kryesorë dhe zbrëthimi i tyre në përbërës ose “nënfaktorë” të cilat do të vlerësohen në përputhje me rrethanat. Performanca e një zinxhiri të vlerës, mund të ndikohet në mënyrë pozitive ose negative, varësisht nga mënyra se si nënfaktorët e ndryshëm ndikojnë në faktorin përkatës të performancës.
2. Kontrollueshmëria – në këtë pyetje ekspertët e dinë se kush është në gjendje të kontrollojë secilin nënfaktorë veç e veç. Këtu iu drejtohem katër alternativave sipas mundësisë së kontrollueshmërisë, siç janë: a) faktorë të kontrolluar nga firma/ferma (FKF), b) faktorë të kontrolluar nga qeveria (FKQ), c) faktorë pjesërisht të kontrolluar (FPK), d) faktorë të pakontrolluar (FP).
3. Faza e tretë përfshinë “Relevancën” dhe “Peshën” e secilit nënfaktorë:

Relevanca: Tregon kontributin pozitiv ose negativ të nënfaktorit në performancën e zinxhirit të vlerës. Vlerësimi sillet nga “shumë i favorshëm” (+2), kur nënfaktori ka një kontribut të rëndësishëm pozitiv në performancën e zinxhirit të vlerës; në “shumë i pafavorshëm” (-2), kur nënfaktori ka telashe ose pengesa për të arritur ose mbajtur performancën. Vlerat midis tyre janë: “favorshëm” me 1 dhe “pafavorshëm” me -1.

Pesha: Secili nënfaktorë peshohet me një vlerë që tregon aftësinë e tij për të ndikuar në performancën e faktorit kryesor të cilit i përket. Vlerat për këtë kategori janë nga 0 deri 1.

Në fund “Relevanca” dhe “Pesha” shumëzohen për të dhënë një vlerësim të përgjithshëm për secilin faktor të performancës.

## **KAPITULLI 4: REZULTATET**

Kapitulli i katërt përfshinë pjesën e analizave dhe rezultateve të hulumtimit, të cilat kanë të bëjnë me të dhënat e përpunuara nga puna në teren. Ky kapitull është ndarë në dy nënkapituj të tjerë, të cilat paraqesin rezultate të veçanta nga njëra tjetra.

Nënkapitulli i parë ka të bëjë me analizat e vlerësimit të faktorit, analizë kjo e cila është paraqitur me grafikone për disa faktor të identifikuar si faktor që ndikojnë në performancën e zinxhirit të vlerës.

Nënkapitulli i dytë, përfshinë analizat dhe rezultatet e pjesës së kontrollueshmërisë dhe relevancës së disa nënfaktorëve të veçantë. Këta nënfaktor kanë lidhshmëri të ngushtë me hipotezat e studimit, ku përmes modelit ekonometrik të ashtuquajtur T-test, kemi vertetur hipotezat e parashtruara.

### **4.1. Vlerësimi i Faktorëve**

Në këtë nënkapitull do të shqyrtojmë pjesën e vlerësimit të faktorëve. Vlerësimi i faktorëve rrjedhë nga shumëzimi i vlerës së Relevancës me vlerën e Peshës, prodhimi i të cilave jep vlerën e Vlerësimit të faktorit. Kjo vlerë tregon gjendjen aktuale të nënfaktorit, i cili ndikon në performancën totale të faktorit në fjalë. Performanca e të gjithë faktorëve karakterizon performancën e zinxhirit të vlerës në sektorin e perimeve. Andaj, do të paraqesim në mënyrë grafike vlerësimin e nënfaktorëve të disa faktorëve më të rëndësishëm.

#### 4.1.1. Tregu Ndërkombëtarë




Figure 2: Vlerësimi i faktorit "Tregu Ndërkombëtarë"


Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni

Ky grafikon është krijuar nga mesatarja e vlerësimit të faktorit për secilin nënfaktor që është identifikuar në kuadër të faktorit "Tregu Ndërkombëtarë". Nga ku shihet se Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe CEFTA kanë vlerë 0.02 dhe 0.03, qka do të thotë se Kosova nuk qëndron mirë me këto dy marrëveshje. Madje sipas respondentëve MSA-ja dhe CEFTA mund të kontribuojnë në performancën e zinxhirit të vlerës, pa dyshim. Mirëpo, nëse flasim për kontributin e tyre në performancën e ZV, atëherë respondentët nuk kanë komente positive në këtë drejtim. Ata mendojnë se MSA-ja nuk ka dhënë kontributin e saj ose ne nuk kemi ditur ta shfrytëzojmë atë, pastaj mendojnë se kjo marrëveshje është sfidë për prodhuesit tanë. CEFTA, gjithashtu, nuk shihet si diçka që ka dhënë kontribut në performancën e ZV, madje mendojnë se ajo është e dështuar.

Barrierat jo-tarifore nuk paraqesin asnjë efekt pozitiv për asnjë shtet. Ato konsiderohen veprime që kanë për qëllim mbrojtjen e prodhimit vendor ose diskriminimin e produkteve në import. Ky veprim ndaj vendit tonë është i dukshëm nga Serbia, e cila paraqet probleme për prodhuesit tanë, e që këto veprime janë të pakontrollueshme nga ana e Kosovës. Madje barrierat jo-tarifore janë barrierat të cilat nuk ndikojnë pozitivisht në performancën e zinxhirit të vlerës. Ashtu siç shihet edhe nga grafiku më lartë, ajo është vlerësuar me vlera negative, ku si përfundim kemi mesataren -0.15. Jo aq mirë qëndron edhe nënfaktori "Barrierat tarifore", e vlerësuar me një vlerë prej -0.10, e cila po bëhet një pengesë për prodhuesit tanë.

Sipas rezultateve të paraqitura në grafikun, prodhuesit tanë qëndrojnë mirë në tregtinë me vendet e tjera. Eksporti i perimeve ndodhë me vendet e regjionit, e cila rezulton të jetë pozitive. Por, nëse kompanitë përpunuese gjejnë tregje në vendet e tjera për shitjen e prodhimit të tyre, atëherë ata duhet të jenë të çertifikuara me Global Gap.

#### 4.1.2. Kulturat (speca & patate)



**Figure 3: Vlerësimi i faktorit "Kulturat (speca dhe patate)"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Nga sektori i perimeve, pjesë të hulumtimit janë kulturat spec dhe patate. Duke marrë parasysh që Kosova karakterizohet me cilësi të mirë të tokës, atëherë kjo është vërtetuar edhe nga analizat e të dhënave të fituara nga puna në teren. Shihet se nënfaktorët: Cilësia e tokës, Analizat e tokës dhe Klima, janë vlerësuar me vlera pozitive. Cilësia e tokës është baza për të prodhuar, e cila e ulë koston e prodhimit, por ne kemi produktivitet të ulët. Respondentët konkludojnë se kemi nivel mesatar të cilësisë së tokës, e aq me tepër ajo mund të pasurohet përmes qarkullimit bimor dhe plehrave të pasura me përqindje të ndryshme të mineraleve. Pastaj, masat e para që një fermer duhet t'i ndërmerr janë analizat e tokës, për të kuptuar se cila kulturë duhet të kultivohet dhe sa është e pasur toka. Një respondent tregon se analizat e tokës janë realizuar nga komuna e tij.


Sa i përket klimës, te patatet dhe te speci i vonshëm klima është e favorshme. Mirepo, neve na nevojiten disa stacione meteorologjike funksionale, të cilat mund të japin të dhëna dhe informata për fermerët në lidhje me motin në ditët në vazhdim. Përmes këtij bashkëpunimi mes stacioneve



meteorologjike dhe fermerëve, fermerët mund të përgatiten për fatkeqësitë që mund të ju kanosen prodhimit të tyre në të ardhmën nga kushtet klimatike; e gjithashtu, duhet të formohet apo organizohet një sistem i breshërit.

Nga grafiku kemi nënfaktorin “Madhësia e fermës”, e cila është vlerësuar me vlera negative nga gati më shumë se gjysma e respondentëve. Këtu kemi vlerën -0.02, pasi që fermat ekzistenciale në Kosovë nuk janë të mëdha, prandaj edhe nga respondentët ky nënfaktor është emëruar si “faktor kufizues”. Madhësia e fermës ndikon në produktivitet, madje sa më e madhe të jetë ferma aq më shumë ndikon në performancën e ZV. Tokat merren me qera, edhe nga mërgimtarët që jetojnë jashtë Kosovës dhe janë pronarë të ndonjë toke këtu.

### 4.1.3. Inputet



**Figure 4: Vlerësimi i faktorit "Inputet"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Inputet janë faktor shumë të rëndësishëm në secilën fazë të prodhimit. Shihet se në aspektin e inputeve qëndrojmë mirë, duke filluar nga fidanet dhe plehu e deri te sherbimet këshillimore. Sipas komenteve të respondentëve, vijmë në përfundim se fara (te patatet) dhe fidanet (te speci) duhet të zgjedhen me kujdesë. Mendohet se cilësinë e fidaneve e kemi problem, mirëpo kohëve të fundit kemi filluar të kultivojmë fidanet e perimeve. Fidanet janë shumë të rëndësishme, edhe pse speci ende mbillet në mënyrë tradicionale, me fidane me rrënjë të zhveshura; e aq më tepër

në serra te speci kultivohen hibridet. Zakonisht fermerët, nëpër fidanishte, kanë blerë 100 copë fidane, mirëpo tani ata blejnë më pak pasi që janë mbetë më pak anëtarë të familjes. Sa i përket patates, kjo kulturë mbillet me farë. Kultura e patates e mbulon tregun vendor dhe nuk kemi problem në mungesën e saj, mirepo kemi mbiprodhim të patateve, saqë ka pasur raste kur fermerët kanë qenë të detyruar të hudhin prodhimin e tyre, sepse nuk kanë gjetur treg për to.


Te nënfaktori “Plehu” kemi vlerën mesatare 0.07, e cila vlerësohet se ka kryesisht cilësi të mirë, mirepo nuk kontrollohet nga askush. Për më tepër, fazat e ndryshme të bimës kërkojnë sasi dhe plehra të mineraleve të ndryshme, por nuk i respektojmë vlerat e plehut që kërkon bima, dhe vendosim më shumë.

Karburantet, uji dhe energjia elektrike kanë vlerën pozitive 0.10, mirëpo nëse shikohen si të veçanta, atëherë arrijmë rezultatet se “Uji dhe “Energjia elektrike” janë neutral me çmim pak të lartë të energjisë elektrike, kurse çmimi i “Karburanteve” është i shtrejtë për bujqësi; madje është i njëjtë sikurse për klientët e tjerë që nuk merren me bujqësi. Çka do të thotë se nuk kemi asnjë dallim në këtë drejtim.

Sa i përket kimikateve, responentët e emërojnë si “thikë me dy teha”, pastaj vazhdojnë me atë se përdorimi i kimikateve duhet të kontrollohet nga vet ferma. Së pari duhet të dihet se si bima e kërkon pesticidin apo kimikatet, cilat janë fazat e para të sëmundjes, apo çfarë problemi ka me dëmtusin, sepse zakonisht përdoren shumë në mënyrë të shfrenuar, e gjithashtu, furnizuesit dinë të manipulojnë me afatet e kimikateve dhe në prejardhjen e tyre. Kur këshilltarët u jepin këshilla fermerëve, ata pak se iu përmbahen këshillave të tyre rreth përdorimit të kimikateve.

Sipas grafikonit, Shërbimet këshillimore private qëndrojnë më mirë sesa Shërbimet këshillimore publike. Mirëpo pavarësisht kësaj, responentët konkludojnë se këto shërbime janë të dobta në përgjithësi, nuk janë të qëndrueshme dhe se ka nevojë për më shumë eksperta në teren; ka mungesë të dijës dhe ekspertëve të fushës.

#### 4.1.4. Fuqia punëtore




**Figure 5: Vlerësimi i faktorit "Fuqia punëtore"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Nënfaktori "Përvoja" figuron me vlerën më të lartë nga të tjerat. Shumë kompani përpunuese punësojnë teknolog nga Serbia, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut, pasi që kemi munges të teknologëve dhe inxhinjerëve. Në Kosovë kemi fuqinë e lirë punëtore; ku sa i përket kualifikimit të saj, me vlerën 0.16 të paraqitur në grafik, por edhe nga puna në teren, shihet çartazi se kemi nevojë për edukim profesional, duke filluar nga sistemi i arsimit. Sa më të arsimuar dhe të dijshtëm të jetë fuqia punëtore, aq më mirë është për fermën/kompaninë përpunuese/pikën grumbulluese, etj. Këto dy nënfaktor dhe këto komente shoqërohen edhe nga nënfaktori "Trajnimet për stafin", ku kemi vlerën mesatare 0.14, por sipas komenteve të respondentëve vijmë në përfundim se nevojitet të ketë më shumë trajnime për prodhimtari, e megjithëse thuhet se kemi shumë trajnime në numër, por jo edhe në cilësi.

#### 4.1.5. Struktura e tregut



**Figure 6: Vlerësimi i faktorit "Struktura e tregut"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni


Në kuadër të faktorit “Struktura e tregut” janë identifikuar nënfaktorët: tregu vendor, tregu rajonal, kontratat/kushtet e pagesës, dhe shitja.

Vlera pozitive kemi në dy faktorët, tregun vendor dhe atë rajonal. Vlera 0.17 e përfaqëson “Tregun vendor”, si një treg mirë të organizuar, mirëpo disa nga respondentët kishin mendime të ndryshme, duke filluar me atë se tregu vendor është i favorshëm për tregtarët, e deri te ankesat se tregu është i vogël dhe se nuk ka shitje të mjaftueshme. Ndërsa tregu rajonal përfaqësohet me vlerën mesatare 0.06. Të gjithë respondentët, nga eksperiencat e tyre, dhanë komente pothuajse të njëjta, ku tregonin se nuk kemi kapacitet prodhues për aq sa kërkon tregu rajonal dhe vendet e tjera, që do të thotë se problemi kryesor është mungesa e prodhimit. Te kultura e patates, tregu rajonal është më i favorshëm, pasi që Kosova eksporton vazhdimisht patate. E gjithashtu, ata komentojnë se, edhe pse tregu rajonal është i ngushtë, është më i favorshëm për tregtarët, duke marrë parasysh se shumica e pikave grumbulluese kanë synim eksportin.

Kontratat/Kushtet e pagesës dhe Shitja janë të shoqëruara me vlerat negative, -0.11 dhe -0.04. Disa respondent konkludojnë se ka filluar të përdoren kontratat me fermerët, mirëpo duhet të bëhet një strategji për nxitjen e përdorimit të tyre. Fillimisht kontratat përdoren vetëm në mënyrë formale, madje hallkat e zinxhirit të vlerës janë të shkëputura, prandaj edhe kontratat nuk funksionojnë siç duhet. Natyrisht se marketingu ndikon pozitivisht në shitjen e prodhimit, e

gjithashtu shitja bëhet në mënyrë të pavarur. Mirëpo, ky nënfaktor nuk është lavdëruar shumë nga respondentët pasi që ka mungesë të tregjeve.

#### 4.1.6. Makroekonomia



**Figure 6: Vlerësimi i faktorit "Makroekonomia"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Nga vlerësimi i nënfaktorëve në grafikon shohim se kemi një laramani të vlerave. Sipas ekspertëve të përfshirë në këtë hulumtim, kushtet për marrjen e kredisë janë të papërbalueshme për fermerët apo edhe për kompanitë përpunuese, prandaj edhe mesataret e vlerësimit të këtyre nënfaktorëve janë vlera negative.

Kur janë pyetur respondentët rreth lehtësisë të marrjes së kredisë, përgjigja e tyre ishte se është shumë lehtë me marrë kredi, mirëpo nuk ka subvencionim të kamatës. Norma e interesit është e lartë, ndërsa periudha e pushimit (Grace) është 6 muaj. Edhe për kredi agrare duhet që klienti të lë hipotekë në bankë, mirëpo ka pasur raste kur fermeri lë në hipotekë investimin e 30 viteve dhe banka të refuzoj t'i jap kredinë.

Taksat në inputet e importuara, ka vlerë pozitive 0.04, ku disa nga inputet që importohen nuk kanë taksë, siç janë: pesticidet, farat, fungicidet, mekanizmi bujqësor, etj.

Ekspertët në përgjithësi nuk janë të kënaqshëm me madhësinë e tregut që kemi, edhe pse është vlerësuar me vlerë pozitive 0.03, ata konkludojnë se ende ka vend për zgjerim të tregut dhe

zëvendësim të importit. Pastaj, shprehin pakënaqësinë e tyre që shumica e popullsisë ka emigruar jashtë Kosovës, është ulë numri i fuqisë blerëse, dhe si rezultat i saj duhet të ulin çmimin nëse rritet numri i tregtarëve në treg.

Nënfaktor tjetër me vlerë pozitive kemi konkurrencën, për të cilën respondentët kanë dhënë komente apo mendime të ndryshme, shikuar nga perspektiva të ndryshme. Përfaqësues të barnatoreve bujqësore kanë deklaruar se ka konkurrencë nga barnatoret e tjera të palicencuara, e të cilat shkaktojnë probleme në këtë hallkë të zinxhirit të vlerës. Për ekspertët e tjerë tregu i jashtëm është konkurrent për prodhuesit tanë, mirëpo disa të tjerë mendojnë se nuk kemi konkurrencë të lartë përderisa kemi mungesë të produkteve në treg dhe importojmë vazhdimisht për plotësimin e tregut vendor. Pastaj, ne importojmë shumë produkte ushqimore, kështu që konkurrenca nuk ndihmon në këtë aspekt, sepse nuk kemi efikasitetin e prodhimit që të konkurojmë me importuesit.

Madhësia e importit është vlerësuar si nënfaktor negativ, sepse kemi sasi të mëdha të importit të produkteve ushqimore. Kosova importon spec për 9 muaj rresht, ndërsa për patate nuk kemi sasi të mëdha të importuara, pasi që mbulojmë vet tregun vendor.

Politikat bujqësore nuk janë lavdëruar shumë nga ekspertët e fushës, sepse mendojnë se nuk kanë dhënë kontributin e tyre, kontributin e duhur, dhe se duhet të rishqyrtohen dhe të riformulohen.

#### 4.1.7. Koordinimi i zinxhirit të vlerës




Figure 7: Vlerësimi i faktorit "Koordinimi i zinxhirit të vlerës"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni

Në kuadër të faktorit "Koordinimi i zinxhirit" kemi identifikuar nënfaktorët: koordinimi vertikal, koordinimi horizontal, rrjeti i informacionit dhe lidhjet tregtare. Koordinimi vertikal përfaqëson bashkëpunimin në mes akterëve të ndryshëm të zinxhirit të vlerës, duke filluar nga prodhuesit, pikat grumbulluese, përpunuesit, tregtarët me shumicë, tregtarët me pakicë, supermarketet, dhe konsumatori. Ndërsa koordinimi horizontal përfaqëson bashkëpunimin në mes akterëve të të njëjtës hallkë të ZV. Sipas rezultateve të analizuar vijnë në përfundim se koordinimi vertikal ka dhënë performancë më të mirë në zinxhirin e vlerës, sesa koordinimi horizontal; e megjithëse koordinimi vertikal është më mirë i zbatuar te kultura e patates.

Rrjeti i informacionit përfshinë reklamat, promovimin, marketingun, etj., del si rezultat se janë të qëndrueshme, pasi që fermerët tani janë më të informuar dhe ka shumë informata që ata mund të marrin nga rrjetet sociale, që sot kanë një përdorim goxha të madh nga shoqëria civile.

Gjithashtu, lidhjet tregtare janë të favorshme dhe të vlerësuara me vlera pozitive.

## 4.2. Kontrollueshmëria, Relevanca dhe Vërtetimi i hipotezave

Komentimin e analizimit të të dhënave do të fillojmë me pjesën e Kontrollueshmërisë dhe Relevancës. Vlerat e relevancës janë paraqitur në mënyrë grafike, për disa nga nënfaktorët e përzgjedhur nga pyetësi në lidhje me hipotezat e hulumtimit.

Relevanca paraqet kontributin që një nënfaktor ka dhënë deri më tani në performancën e zinxhirit të vlerës. Ajo ka pesë shkallë të vlerësimit, duke filluar nga:

1. “Shumë e pafavorshme” që përfaqësohet me vlerën -2,
2. “E pafavorshme” me vlerën -1,
3. “Neutrale” me vlerën 0,
4. “E favorshme” me vlerën 1, dhe
5. “Shumë e favorshme” me vlerën 2.

Kontrollueshmëria paraqet faktin se kush e kontrollon nënfaktorin në fjalë. Kjo përfaqësohet nga katër nivele, siç janë:


1. Faktor i kontrollueshëm nga ferma/biznesi (FKF)
2. Faktor që kontrollohet nga qeveria (FKQ)
3. Faktor pjesërisht i kontrollueshëm (FPK)
4. Faktor i pakontrollueshëm (FP)

Në këtë pjesë të pyetësit, respondentët kanë pasur mundësi të zgjedhin një ose më shumë përgjigje.

Të gjitha do t'i shqyrtojmë në vijim, ku relevanca paraqitet në mënyrë grafike.




#### 4.2.1. Relevanca – Koordinimi vertikal dhe horizontal



**Figure 8: Relevanca për nënfaktorin "Koordinimi Vertikal"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni


Nga përshkrimi i lartëshënuar për relevancën, kemi grafikun i cili paraqet vlerësimin e nënfaktorit “Koordinimi vertikal” për kontributin që ka dhënë deri më sot në performancën e zinxhirit të vlerës, sipas përqindjes së respondentëve. Shihet çartë se 38% e respondentëve (9 respondent) kanë deklaruar se koordinimi vertikal ka dhënë kontribut të favorshëm në performancën e zinxhirit të vlerës. 25% e tyre ose 6 respondent kanë deklaruar që kontributi i koordinimit vertikal është neutral, shoqëruar nga 21% (5 respondent) që kanë deklaruar se kontributi i këtij nënfaktori ka qenë i pafavorshëm në performancën e zinxhirit të vlerës.



**Figure 9: Relevanca për nënfaktorin "Koordinimi Horizontal"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni

Ndërsa sa i përket koordinimit horizontal, bashkëpunimit të akterëve të të njëjtës hallkë zinxhimore, shihet se 21% ose 5 respondent kanë vlerësuar se koordinimi horizontal ka dhënë kontribut të favorshëm në performancën e ZV. Pavarësisht kësaj, 54% e respondentëve (13 respondent) kanë vlerësuar se kontributi i koordinimit horizontal është neutral; kjo do të thotë se nuk ka dhënë kontribut as negativ e as pozitiv.



Përveç kësaj, respondentët kanë peshuar aftësinë e të dy faktorëve për të ndikuar në performancën e zinxhirit të vlerës. Vlera mesatare e peshës së nënfaktorit “Koordinimi vertikal” është 0.30, që është vlerë më e madhe se 0.21 si vlerë për të peshuar nënfaktorin tjetër.

Duke mos e lënë me kaq, 67% e respondentëve kanë konkluduar se koordinimi vertikal është nënfaktor që kontrollohet nga ferma/biznesi

Figure 10: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Koordinimi Vertikal"

(pika grumbulluese, kompania përpunuese, etj.), kjo shoqërohet nga 21% e respondentëve që kanë konkluduar se nënfaktori në fjalë është faktor i kontrollueshëm nga ferma/biznesi së bashku me qeverinë. 63% e respondentëve janë përgjigjur se koordinimi horizontal kontrollohet nga ferma/biznesi, kurse 25% e tyre kanë dhënë përgjigjen se është faktor që kontrollohet nga të dyja, nga ferma/biznesi dhe nga qeveria.




Figure 11: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Koordinimi Horizontal"

### Vërtetimi i hipotezës I:

**H<sub>0</sub>:** Koordinimi verikal, në krahasim me atë horizontal nuk ka ndikim më të madh në performancën e zinxhirit të vlerës

**H<sub>1</sub>:** Koordinimi verikal, në krahasim me atë horizontal ka ndikim më të madh në performancën e zinxhirit të vlerës

Table 4: Analizimi i hipotezës me T-test

t-Test: One-Sample

	<i>Koordinimi vertikal</i>
Mean	0.111664
Variance	0.086423
Observations	24
Pooled Variance	0.064845
Hypothesized Mean	0
df	46
t Stat	0.486071
P(T<=t) one-tail	0.314612
t Critical one-tail	1.67866
P(T<=t) two-tail	0.629224
t Critical two-tail	2.012896

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Për të vërtetuar hipotezen fokusohemi në vlerat e t-testit. Kur t-testi tabelar është më i madh se ai i llogaritur, atëherë pranohet hipoteza bazë, ndërsa hudhet poshtë hipoteza alternative. Kur t-testi tabelar është më i vogël se ai i llogaritur, atëherë pranohet hipoteza alternative dhe hudhet poshtë hipoteza bazë. Në rastin tonë t-testi tabelar ose faktik është 1.67, ndërsa t-testi i llogaritur është 0.48, që do të thotë se vlera e t-testit tabelar është më e madhe se ai i llogaritur, atëherë pranojmë hipotezën bazë.

$$1.67 > 0.48$$

Me këtë analizë ne pranojmë hipotezën bazë, dhe mund të themi se me një nivel të besueshmërisë prej 95% konstatojmë se koordinimi vertikal në krahasim me atë horizontal nuk ka ndikim më të madh në performancën e zinxhirit të vlerës. Me këtë vijmë në përfundim se të

dy koordinimet kanë rëndësi dhe peshë të njëjtë, pasi që bashkëpunimi mes akterëve të të njëjtës hallkë dhe hallkave të ndryshme zinxhirore është shumë i rëndësishëm për të pasur sukses dhe një performancë më të mirë të ZV.

#### 4.2.2. Relevanca – Politikat bujqësore




Figure 12: Relevanca për nënfaktorin "Politikat bujqësore"

Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni

Grafikoni i lartëparaqitur tregon se 29% ose 7 respondent kanë deklaruar se kontributi i politikave bujqësore, deri më tani, ka qenë neutral. Kurse 29% (7 respondent) prej tyre mendojnë se kontributi i politikave bujqësore ka qenë i favorshëm, por vetëm 25% (6 respondent) e respondentëve mendojnë se kontributi i tyre ka qenë i pafavorshëm; e që komentojnë se politikave bujqësore nuk kanë dhënë kontributin e duhur apo kontributin sipas qëllimit të krijuar, dhe se ato duhet të rishqyrtohen dhe riformulohen.




Figure 13: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Politikat bujqësore"

Gjithashtu, 92% e respondentëve ose 22 prej tyre deklarojnë se nënfaktori në fjalë është i kontrollueshëm nga qeveria.

## Vërtetimi i hipotezës II:

**H<sub>0</sub>:** Politikat bujqësore nuk kanë dhënë kontributin e tyre në performancën e zinxhirit të vlerës

**H<sub>1</sub>:** Politikat bujqësore kanë dhënë kontributin e tyre në performancën e zinxhirit të vlerës

Table 5: Analizimi i hipotezës me T-test

t-Test: One-Sample

<i>Politikat bujqesore</i>	
Mean	0.041667
Variance	1.259058
Observations	24
Hypothesized Mean	0
df	23
t Stat	0.181916
P(T<=t) one-tail	0.428621
t Critical one-tail	1.713872
P(T<=t) two-tail	0.857242
t Critical two-tail	2.068658

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme, shohim se sipas këtij modeli ekonometrik vlera t tabelare është më e madhe sesa vlera e t së llogaritur. Kjo tregon se duhet të pranojmë hipotezën bazë (H<sub>0</sub>). Kjo pasi që vlera e t tabelare është 1.71, kurse vlera e t e llogaritur është 0.18, prandaj kemi:

$$0.18 < 1.71$$

Pasi që duhet të pranojmë hipotezën bazë H<sub>0</sub>, atëherë themi se politikat bujqësore nuk kanë dhënë kontributin e duhur në performancën e zinxhirit të vlerës. Kjo mund të vërtetohet edhe nga komentet e respondentëve, të cilët thanë se ato duhet të rishqyrtohen dhe të riformulohen. Për më shumë, nga grafiku i mësipërm shohim se 23% e respondentëve kanë thënë se kontributi i politikave bujqësore ka qenë neutral, kjo do të thotë se ata kanë qenë skeptik rreth efektit të politikave bujqësore.

### **Vërtetimi i hipotezës III:**

Hipoteza e tretë e këtij studimi ka të bëjë me funksionimin e dobët të një hallke të zinxhirit të vlerës. Kjo hipotezë do të komentohet dhe vërtetohet duke u bazuar në të dhënat primare dhe sekondare, me fjalë të tjera, duke u bazuar në rishikimin e literaturës dhe punën e terenit.

Andaj kemi hipotezat:

**H<sub>0</sub>:** Funksionimi i dobët i vetëm një hallke të zinxhirit të vlerës nuk ka ndikim në qëndrueshmërinë e kompanisë


**H<sub>1</sub>:** Funksionimi i dobët i vetëm një hallke të zinxhirit të vlerës ka ndikim në qëndrueshmërinë e kompanisë

Atëherë, siç e kemi cekur edhe në pjesën e identifikimit të problematikës, mund të konkludojmë se nëse një hallkë e ZV nuk funksionon mirë apo ka ngecje në zhvillim, atëherë natyrisht se do të kenë ngecje të gjitha hallkat e tjera pas saj. Problemi kryesor i përpunuesve të pemëve dhe perimeve është mungesa e lëndës së parë, pasi që fermerët nuk iu përmbahen kontratave ashtu siç duhet. Kjo ndodhë për shumë arsye, duke filluar nga ndryshimet klimatike, dëmtuesit, sëmundjet e ndryshme, çmimi kontraktues në krahasim me çmimin në treg, etj. Përveç kësaj, janë edhe pikat grumbulluese të cilat furnizohen nga prodhuesit, por nuk i furnizojnë kompanitë përpunuese me sasinë e duhur, pasi që janë të orientuar drejt eksportit.

Prandaj, nga kjo mund të vijmë në përfundim se funksionimi i dobët i prodhuesve si hallkë e ZV ka ndikim në qëndrueshmërinë e kompanisë përpunuese, por edhe të pikës grumbulluese. Pasi që, hallka kyesore e ZV, pra furnizimi me lëndë të parë, nuk funksionon ashtu siç duhet, atëherë kompanitë përpunuese nuk do të jenë të qëndrueshme dhe nuk do të arrijnë të realizojnë qëllimin e tyre.

Nga kjo analizë mund të themi se e pranojmë hipotezën alternative H<sub>1</sub>, pasi që funksionimi i dobët i vetëm një hallke të zinxhirit të vlerës ka ndikim në qëndrueshmërinë e kompanisë.

### 4.2.3. Relevanca - Fidanet




**Figure 14: Relevanca për nënfaktorin "Fidanet"**

Burimi: Analizimi i të dhënave nga tereni

Tani do të analizojmë kontributin e nënfaktorit "Fidanet" në performancën e zinxhirit të vlerës. Duke marrë parasysh se kultura e patates nuk mbillet me fidane, por vetëm me farë, atëherë, kjo analizë ka të bëjë vetëm për kulturën e specit, kulturë kjo e cila mund të mbillet edhe me fidane. Nga grafiku duket çartë se 33% (8 respondent) e ekspertëve të përfshirë në këtë studim kanë deklaruar se fidanet kanë dhënë kontribut të favorshëm, por po aq respondent kanë deklaruar se fidanet kanë dhënë kontribut të pafavorshëm.

Kemi pjesën e kontrollueshmërisë ku 42% ose 10 respondent deklarojnë se fidanet duhet të kontrollohen si nga ferma ashtu edhe nga qeveria. Kurse 38% ose 9 prej tyre deklarojnë se fidanet duhet të kontrollohen vetëm nga ferma. Gjithashtu, respondentet shtojnë se duhet të zgjedhet fara dhe fidani



**Figure 15: Kontrollueshmëria për nënfaktorin "Fidanet"**

me kujdes, si dhe cilësia e fidaneve është ende problem te prodhuesit. Kultura e specit ende mbillet me fidane me rrënjë të zhveshura, e cila ndikon pastaj në rendiment dhe cilësi të frutit.

## Vërtetimi i hipotezave IV:

**H<sub>0</sub>:** Bujqësia tradicionale e përdorur në vend nuk ndikon në prodhimtarinë e perimeve

**H<sub>1</sub>:** Bujqësia tradicionale e përdorur në vend ndikon në prodhimtarinë e perimeve

Table 6: Analizimi i hipotezës me T-test

t-Test: One-Sample

	<i>Fidanet</i>
Mean	0.5
Variance	1.478261
Observations	24
Hypothesized Mean	0
Df	23
t Stat	2.014652
P(T<=t) one-tail	0.027889
t Critical one-tail	1.713872
P(T<=t) two-tail	0.055778
t Critical two-tail	2.068658

Burimi: Analizimi i të dhënave nga terreni

Edhe hipotezën e katërt e vërtetojmë përmes t-testit, i cili na ndihmon të analizojmë dhe vërtetojmë më saktë hipotezat e parashtruara. Atëherë, kemi vlerat me një diferencë jo shumë të madhe nga njëra tjetra. Vlera e t-testit tabelar është 1.71, kurse vlera e t-testit të llogaritur është 2.01, çka do të thotë se t-testi i llogaritur është më i madh se vlera e t-testit tabelar:

$$2.01 > 1.71$$

Pra, këto vlera na tregojnë se ne duhet të pranojmë hipotezën alternative H<sub>1</sub>, dhe mund të themi se jemi të sigurt me 95% shkallë të besueshmërisë se bujqësia tradicionale e përdorur në vend ndikon në prodhimtarinë e perimeve.



## KAPITULLI 5: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 5.1. Përfundime

Analizimi i zinxhirit të vlerës është një hulumtim shumë i rëndësishëm, në çdo aspekt. Ajo është i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të bujqësisë, por edhe në furnizimin e tregut vendor me prodhime vendore.

Metoda e përdorur për këtë hulumtim ka dhënë kontributin e saj për të analizuar të gjitha hallkat e zinxhirit të vlerës në mënyrë të shpejtë, duke vlerësuar kontributin dhe aftësinë e faktorëve që ndikojnë në performancën e saj, dhe jo vetëm. Përmes kësaj metode ne kemi arritur rezultatet e dëshiruara dhe kemi arritur të identifikojmë ngecjen ose edhe suksesin e zhvillimit të zinxhirit të vlerës te perimet.

Nga rezultatet e arritura vijmë në përfundim se Kosova nuk ka pasur ndonjë ndryshim nga anëtarësimi apo nënshkrimi i marrëveshjes së MSA-së dhe CEFTA-s. Me fjalë të tjera mund të themi se, marrëveshjet e Kosovës në CEFTA dhe MSA nuk kanë dhënë kontributin e duhur. Madje, barrierat jo-tarifore janë barrierat, të cilat janë duke penguar procesin e zhvillimit të kompanive tona. Këto lloj barrierash vendosen nga Serbia ndaj prodhimeve tona.

Kosova është mjaftë e begatë, duke filluar nga kushtet klimatike e deri te relievi dhe cilësia e tokës. Pavarësisht kësaj, produktiviteti është i ulët. Realizimi i analizave të tokës është një veprim që çdo fermer duhet ta bëjë përpara se të filloj mbjelljen e çfarëdo kulture, e aq më tepër të perimeve. Mirëpo, nga literatura e lexuar, eksperiencia e punës dhe nga komentet e respondentëve, vijmë në përfundim se jo të gjithë fermerët i realizojnë analizat e tokës. Kjo është diçka që mund të paraqes problem në biznes, si dhe në ulje të rendimentit. Për kulturat e patates dhe të specit të vonshëm klima është e favorshme, mirëpo pavarësisht kësaj, shihet si e nevojshme funksionalizimi i stacioneve meteorologjike për parashikimin e saktë të motit dhe kushteve klimatike. Problem tjetër që është i dukshëm në vendin tonë është edhe madhësia e vogël e fermave, ku madhësia mesatare e fermave në Kosovë është 3.5ha për perime. Andaj, këtë faktor e emërojmë si “faktor kufizues”.

Me kohën po ecën edhe zhvillimi i teknologjisë, e cila po ndihmon dhe lehtëson procesin e punës. Teknologjia që përdoret ende në Kosovë në hallkën e prodhimit është ende tradicionale. Përzgjedhja e fidaneve për kultivimin e specit, dhe përzgjedhja e farës për kultivimin e patateve duhet të bëhet me kujdesë. Sipas analizave rreth nënfaktorit “Fidanet”, vijmë në përfundim se mënyra e mbjelljes së tyre ndikon shumë në produktivitetin e prodhimit përfundimtar. Fidanet ende mbillen sipas metodës tradicionale, e cila nuk mund të jap ndonjë efekt apo sukses më të madh sesa ky që është arritur deri më sot. Pastaj, për të arritur rendiment më të madh, fermerët e shtojnë më shumë përdorimin e plehrave kimike, gjë e cila nuk është veprim i mirë.

Sa i përket ujit, energjisë elektrike dhe karburanteve, atëherë vijmë në përfundim se karburantet janë me çmime të njëjta për të gjithë konsumatorët, pavarësisht nëse merren me sektorin e bujqësisë apo jo. Ulja e çmimit të karburanve për klientët që punojnë sektorin e bujqësisë ekziston si mundësi, mirëpo kjo duhet vetëm të zbatohet me korrektësi.

Shërbimet këshillimore janë ato të cilat duhet të ndikojnë pozitivisht në secilën hallkë të zinxhirit. Duke mos menduar për qëllimin e saj të mirë, por vetëm për punën e realizuar, mund të themi se shërbimet këshillimore nuk janë duke u zbatuar ashtu siç duhet.

Fuqia punëtore duhet të specializohet. Kosova ka një numër të madh të rinisë, e cila është mjaftë e aftë të shkollohet dhe të specializohet në fusha të ndryshme, e në rastin tonë edhe në fushën e sektorit të bujqësisë. Mirëpo nga ky hulumtim, si përfundim, mund të themi se kemi mungesë të fuqisë punëtore të specializuar. Madje edhe tranimet për stafin nuk janë aq cilësore sa janë edhe në numër.

Përfundim tjetër që mund të veçojmë nga rezultatet është edhe tregu vendor dhe tregu rajonal. Nga komentët e ekspertëve, tregjet janë të favorshme më së shumti për tregtarët, mirëpo pavarësisht kësaj mund të themi se tregu vendor është treg i vogël, i kufizuar. Ndërsa për tregun rajonal, mund të vijmë në përfundim se kërkon sasi të madhe të prodhimit, e që Kosova nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për plotësimin e kërkesave të tyre.

Mos përdorimi i kontratave është një problem tjetër. Nga literatura e lexuar ne mund të nxjerrim përfundimin se kontratat nuk zbatohen në mënyrë të duhur, e aq më tepër kjo u vërtetua edhe nga puna në teren.

Shumica e fermerëve, investimin që e bëjnë në biznesin e tyre është investim vetanak. Marrja e një kredive bujqësore ka shumë kriterë, të cilat jo shumë fermer mund t'i përballojnë. Normat e larta të interesit dhe vendosja e pasurisë në hipotekë mund të jenë kushte sfiduese për fermerin.

Analizimi i të dhënave nga tereni dhe konkludimet e ekspertëve rreth politikave bujqësore, jep një sinjal me ngjyrë të kuqe që këto politika nuk janë zbatuar ashtu siç duhet. Andaj, duhet të hulumtohet më shumë rreth realitetit që ndodhet në fushë dhe të riformulohen të gjitha politikat bujqësore. Rritja e sipërfaqeve të punuara është shumë e rëndësishme dhe ndikon në rritjen e sasisë së rendimentit. Edhe pse politikat bujqësore janë formuluar në atë mënyrë që subvencionimet të bëhen varësisht nga sasia e prodhimit, kjo nuk është zgjidhje; sepse për të arritur një sasi më të madhe të prodhimit fermerët përdorin sasi më të mëdha të prehrave dhe kimikateve, gjë e cila nuk është veprim i favorshëm për tu ndërmarrë.

Sa i përket koordinimit vertikal dhe horizontal, nga rezultatet vijmë në përfundim se të dy koordinimet janë të rëndësishme në performancën e zinxhirit të vlerës. Natyrisht se suksesi është i pandalshëm nëse gjithëmonë ka bashkëpunim mes hallkave të ndryshme të zinxhirit të vlerës. Nëse i analizojmë bashkëpunimin mes akterëve të ZV te kultura e patates dhe te kultura e specave, si dhe nga komentet e respondentëve, vijmë në përfundim se zinxhiri i vlerës funksionon më mirë te kultura e patates sesa te kultura e specit.

Pastaj, kemi nënfaktorin “Gruaja në biznes”. Jemi në dijeni se kohëve të fundit ka filluar të hyj në fuqi si kriter “Gratë ndërmarrëse”, ku aplikimet për grante e favorizojnë gjininë femrore për biznes. Pavarësisht idesë që është shumë mirë e menduar, nuk kemi lavdërime të mëdha për zbatimin e saj. Apo ndoshta, më mirë të themi se kjo ide është dalë nga kontrolli dhe është keqpërdorur nga shumë familje të cilat merren me biznese në fushën e bujqësisë. Nga qëllimi për vetëdijësim të popullatës, ka kaluar në manipulim të marrjes së dokumenteve apo emrit të vajzës ose gruas, të cilat mund të mos jenë as në dijeni për këtë, vetëm e vetëm të fitojnë grante apo edhe kredi në emër të tyre.

Në Kosovë ka shumë organizata të specializuara hulumtuese, si vendore ashtu edhe të huaja. Këto organizata realizojnë hulumtime shumë të mira gjatë veprimtarisë së tyre, mirëpo me përfundimin e projektit përfundon edhe hulumtimi, nga i cili nuk ka asnjë ndikim në përmirësimin e zinxhirit të vlerës.

## 5.2. Rekomandimet

Rezultatet dhe përfundimet janë shumë mirë të paraqitura dhe të elaboruara, të cilat vënë në pah ngecjet dhe rezultatin aktual të faktorëve të identifikuar në këtë studim.

Atëherë, kemi seksionin e rekomandimeve, ku do të japim rekomandimet për faktorët që sipas analizave kanë rezultuar të kenë ngecur së zhvilluari. Pastaj kjo ngecje ka ndikur edhe në mos-funksionimin e mirë të zinxhirit të vlerës së sektorit të perimeve.

Rekomandohet:

1. Kosova të filloj të shqyrtoj të gjitha mundësitë nga marrëveshjet e bëra, për të arritur një sukses më të madh në zinxhirin e vlerës
2. Funkcionalizimi i stacioneve meteorologjike për parashikimin e saktë të motit dhe kushteve klimatike, si dhe bashkëpunimi me fermerë në mënyrë që të informohen nga pala kryesore
3. Mbjellja e fidaneve sipas metodës moderne, përmes moduleve (kasetave)
4. Instalimi i sistemit të ujitjes pikë-pikë, si dhe hapja e bunareve në rast të mungesës së ujit
5. Mungesa e energjisë elektrike mund të zgjidhet si problem me instalimin e paneleve diellore
6. Rritja e numrit të ekspertëve për shërbimet këshillimore dhe inspektorëve në teren
7. Të gjitha kompanitë përpunuese dhe fermat komerciale të ndajnë një pjesë të buxhetit të tyre për trajnimet efektive për stafin e tyre. Kjo mund të rezultoj në rritjen e kapaciteteve të njohurive të stafit, dije kjo e cila pastaj kthehet në suksesin e biznesit
8. Noterizimi i kontratave dhe zbatimi i dënimeve të mospërbushjes së kontratave
9. Krijimi i një buxheti nga ana e shtetit për subvencionimin e kamatës së kredive bujqësore
10. Bashkimi dhe konsolidimi i tokave bujqësore, si rezultat i bashkimit të fermerëve. Edhe nëse një parcelë në mes të tokave bujqësore nuk punohet, atëherë ajo parcelë të dhurohet me qera për grupin e fermerëve që punojnë tokat afër saj, dhe një përqindje e vogël e fitimit t'i jepet pronarit të asaj parcele si pagesë e dhënies me qera. Kjo është mënyrë nga e cila të dy palët përfitojnë.

11. Sistemi i arsimit duhet të rregullohet në atë mënyrë që studentët të kenë më shumë mundësi për punë praktike, e cila rezulton pastaj në specializimin e tyre si fuqi e ardhshme punëtore.
12. Qeveria duhet të krijoj një departamet në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, i cili vazhdimisht hulumton zinxhirin e vlerës si proces në zhvillim.

## Referencat

- Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. (2009, July 27). *LIGJI NR.03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL*. Retrieved July 27, 2009, from Gazeta e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2642>
- AGRO.RECURA. (2019). *Udhezues per kulturen e specit*. Prishtine: AGRO.RECURA.
- Attaie H. Fourcadet O. (2003). *Guidelines for Value Chain Analysis in the Agri-Food Sector of Transitional and Developing Economies*. France: International Agri-Food Management.
- Carlos A. da Silva, Hildo M. de Souza Filho. (2007). *Guidelines for rapid appraisals of agrifood chain performance in developing countries*. Italy: FAO.
- DAESB. (2015). *Analiza e tregut të patates*. Prishtinë: MBPZHR.
- DAESB. (2015). *Analiza e tregut të specit*. Prishtinë: MBPZHR.
- FAO. (2020, September 23). *Global trade in food and agricultural products more than doubles in last two decades*. Retrieved September 23, 2020, from FAO: <http://www.fao.org/news/story/en/item/1309369/icode/>
- FAO. (n.d.). *Community forestry - Rapid Appraisal*. Retrieved from FAO: <http://www.fao.org/3/t7845e/t7845e03.htm>
- Fischer, CH. (2002). *The Market for Fruit & Vegetables in Kosovo and Balkan Regional Market Study*. Prishtine: Intercooperation .
- Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. (2012, October 16). *LIGJI Nr. 04/L-090 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL*. Retrieved October 16, 2012, from Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2848>
- Gilbeaux, K. (2012, February 21). *Rapid Appraisal Methods*. Retrieved February 21, 2012, from U.S. Resilience System: <https://us.resiliencesystem.org/rapid-appraisal-methods>
- Gomez, M. Ricketts, K. (2013). *Food value chain transformations in developing countries*. FAO.
- Kaçiu, S. (2008). *Study of the current situation of pepper production in Kosovo*. Prishtine: Inter Cooperation.
- Lajqi, S. Thaqi, M. Kaçiu, K. Bytyqi, H. Krasniqi, B. (2017, December). *Impact of Agricultural Intervention Programs on Income and Employment: Evidence from Vegetable Sector in Kosovo*. Retrieved December 2017, from Research Gate: [https://www.researchgate.net/publication/325794405\\_Impact\\_of\\_Agricultural\\_Intervention\\_Programs\\_on\\_Income\\_and\\_Employment\\_Evidence\\_from\\_Vegetable\\_Sector\\_in\\_Kosovo](https://www.researchgate.net/publication/325794405_Impact_of_Agricultural_Intervention_Programs_on_Income_and_Employment_Evidence_from_Vegetable_Sector_in_Kosovo)

- Malmfors, Garnsworthy, Grossman. (2004). *Writing and Presenting Scientific Papers. 2nd Edition*. Nottingham: Nottingham University Press.
- MBPZHR. (2018). *Raportii Gjelbër 2018*. Prishtine: MBPZHR.
- MBPZHR. (2019). *Raportii Gjelbër 2019*. Prishtinë: MBPZHR.
- Miftari, I. (2016). *CAPACITY DEVELOPMENT OF MAFRD ECONOMIC ANALYSIS UNIT ON AGRICULTURAL POLICY IMPACT ASSESSMENT*. Prishtine: FAO.
- Miftari, I. (2016). *Përmbledhja e raportit për zinxhirin e vlerës*. Prishtina: FAO Regional Office for Europe and Central Asia.
- Miftari, I. (2019). *Zinxhiri i vlerës në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë*. Prishtine: PePeKo.
- Odat Ekonomike, Këshilli i Investitorëve Evropian, Klubi i Prodhuesve të Kosovës. (2020). *Ankete mbi ndikimin e COVID-19 në ndermarrjet në Kosove*. Prishtine: RECURA.
- Pattanayak, S. (n.d.). *Rapid Appraisal Methods*. Retrieved from Projects: [https://projects.ncsu.edu/project/cnrint/GHANA/rra\\_notebook.pdf](https://projects.ncsu.edu/project/cnrint/GHANA/rra_notebook.pdf)
- PPSE. (2014). *Produktet e pemeve dhe perimeve te perpunuara ne Kosove*. Prishtina: ProFound.
- PPSE. (2017). *Research Study on Producers-Retailers Relationships*. Prishtina: RIINVEST INSTITUT.
- Qeveria e Republikës së Kosovës. (2020, Mars 5). *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020-2023*. Retrieved Mars 5, 2020, from [https://www.koha.net/uploads/files/2020/March/06/Programi\\_i\\_Qeverise\\_se\\_Kosoves\\_2020-2023\\_watermark1583513074.pdf](https://www.koha.net/uploads/files/2020/March/06/Programi_i_Qeverise_se_Kosoves_2020-2023_watermark1583513074.pdf)
- Stafa, A. (2018). *ANALIZA E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT, EFEKTIVITETI DHE NDIKIMI I DHOMAVE FRIGORIFERIKE NË STIMULIMINE PRODHIMIT "Rasti i mollëve në Rajonin e Dibrës dhe Korçës"*. Durrës: UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS.
- Townsley, P. (1993). *A manual on Rapid Appraisal Methods for coastal communities*. Madras, India: Bay of Bengal Programme.
- USAID. (2007). *Kosovo Sector Assessment & Selection Report - An evaluation of growth opportunities, challenges, and impact potential*. Prishtina: USAID.
- World Bank. (1993). An overview of rapid appraisal methods in development settings. In K. Kumar, *An overview of rapid appraisal methods in development settings* (pp. 8-22). Washington D.C.: World Bank.
- World Bank Group. (2020). *Trading for Development in the Age of Global Value Chains*. Prishtina: World Bank Group.

World Bank Group. (n.d.). *Global Value Chains*. Retrieved from World Bank :  
<https://www.worldbank.org/en/topic/global-value-chains>

World Trade Organization. (2019, April 15). *Technological Innovation, Supply Chain Trade, And Workers in a Globalized World*. Geneva: World Trade Organization.



## Aneks

Faktorët dhe nënfaktorët	Kontrollueshmëria				Relevanca		Pesha	Vlerësimi i faktorit
	FKF	FKQ	FPK	FP	Simb.	Vlera	0-1	
<b>Tregu ndërkombëtarë</b>								
MSA								
CEFTA								
Barrierat jo-tarifore								
Barrierat tarifore								
Tregjet me vendet e tjera								
<b>TOTAL</b>								
<b>R&amp;D (Kërkim dhe Zhvillim)</b>								
Fuqia punëtore e specializuar								
Organizata të specializuara hulumtuese								
<b>TOTAL</b>								
<b>Kulturat (specat &amp; patate)</b>								
Cilësia e tokës								
Analizat e tokës								
Klima								
Madhësia e fermës								
<b>TOTAL</b>								
<b>Ambienti</b>								
Ekonomik, Tregtar								
Social								
Natyror								
Gruaja në biznes (të drejtat e pronës)								
<b>TOTAL</b>								
<b>Pajisjet</b>								
Teknologjia e përdorur								
Asistenca teknike (ekspertiza)								
<b>TOTAL</b>								
<b>Inputet</b>								
Fidanet								
Plehu								
Karburantet, Uji dhe E. elektrike								
Kimikatet								
Shërbimet këshillimore private								

Faktorët dhe nënfaktorët	Kontrollueshmëria				Relevanca		Pesha	Vlerësimi i faktorit
	FKF	FKQ	FPK	FP	Simb.	Vlera	0-1	
Shërbimet këshillimore publike								
<b>TOTAL</b>								
<b>Fuqia punëtore</b>								
Kualifikimi								
Pervoja								
Trajnimet per stafin								
<b>TOTAL</b>								
<b>Struktura e tregut</b>								
Tregu vendor								
Tregu rajonal								
Kontratat/Kushtet e pagesës								
Komercializimi/Shitja								
<b>TOTAL</b>								
<b>Menaxhimi në fermë</b>								
Planifikimi i prodhimit								
Menaxhimi i cilësisë								
Kontabiliteti në fermë								
Burimet e financimit të investimeve								
Bashkëpunimi me akterët e ZV								
Vendimmarrja								
<b>TOTAL</b>								
<b>Makroekonomia</b>								
Lehtësia e perfitimit te kredise								
Norma e interesit								
Periudha e pushimit (Grace)								
Hipoteka								
Inflacioni								
Te ardhurat								
Taksa ne imputet e importuara								
Madhësia e tregut								
Konkurrenca								
Kapaciteti i eksportit								
Madhësia e importit								
Politikat bujqesore								
<b>TOTAL</b>								

Faktorët dhe nënfaktorët	Kontrollueshmëria				Relevanca		Pesha	Vlerësimi i faktorit
	FKF	FKQ	FPK	FP	Simb.	Vlera	0-1	
<b>Rregullativa e Sigurise Ushqimore</b>								
HACCP								
ISO								
GLOBAL GAP								
BIO								
<b>TOTAL</b>								
<b>Inspektimi</b>								
Sistemi i shërbimit të inspektimit								
Inspektimi Sanitar/Fitosanitar								
<b>TOTAL</b>								
<b>Koordinimi i zinxhirit</b>								
Koordinimi vertikal								
Koordinimi horizontal								
Rrjeti i informacionit								
Lidhjet tregtare								
<b>TOTAL</b>								